ADMINISTRATOR SHOQEROR

PAOLA DEMIRI







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Nr. 185/4 prot

Tepelene me 25/01/2024

PROJEKT – VENDIM

NR. \_\_\_\_ DATE \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

“MIRATIM KERKESE PER SHPREHJE INTERESI PER SHITJEN E NJE APARTAMENTI NE QYTETIN E TEPELENES, E CILA ESHTË NE PRONESI TE DEGES RAJONALE GJIROKASTER TE EKB-se.

Keshilli Bashkiak Tepelene ne mbledhjen e dates \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024 pasi mori ne shqyrtim kerkesen e Bashkise Tepelene, per miratim te kerkeses per shprehje interesi te shitjes se nje apartamenti ne njesine administrative Tepelene, e cila eshte ne pronesi te Deges Rajonale Gjirokaster si dhe kerkesen e qytetarit Melisa Dulaj per shprehje interesi per blerje te ketij apartamenti vlersoj:

Duke u mbështetur ne ligjin 22/2018 “Per Strehimin Social, ligjin 139//2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”, shqyrtoj gjithë dokumentacionin bashkelidhur relacionit te Komisionit te Strehimit prane Bashkise Tepelene, dhe ne perfundim:

V E N D O S I

Te miratoj kerkesen e Bashkise Tepelene ne lidhje me interesin e qytetarit znj. Melisa Dulaj per blerje apartamenti nga EKB ,Dega Gjirkaser.

Ky vendim hyne ne fuqi menjeher.

**Jurist**

**Julinda Karteri**

**Kryetari Keshillit**

**Arben Gumeni**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË  
KOMISIONI STREHIMIT**

Nr. \_\_ Prot

Tepelenë, me \_\_ / \_\_ / 2024

**RELACION**

“ Mbi kerkesen per vlersimin dhe shprehje interesi per shitjen e nje apartamenti ne qytetin e Tepelenes ne pronesi te Deges Rajonale Gjirokaster te EKB-se,,

Komisioni Strehimit i Bashkise Tepelene pasi mori ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Enti Kombetar i Banesave, “ Kerkese per vlersimin dhe shprehje interesi per shitjen e nje apartamenti ne qytetin e Tepelenes, e cila eshte ne pronesi te Deges Rajonale Gjirokaster te EKB-se,, me shkresen Nr.02 dt 09.01.2024 “ Kerkese per miratimin e nje familje per strehim ne nje apartament me nr pasurie 22/42+1-18/1 te ndodhur ne njesine administrative Tepelene,Bashkia Tepelene,, veproj si me poshte:

Ne mbeshtetje te ligjit 22/2018 “Per Strehimin Social,, komisioni strehimit shqyrtoj kerkesen e paraqitur nga znj.Melisa Dulaj banor i bashkise Tepelene per shprehje interesi per blerje banese ,pasi sipas dokumentacionit te kerkuar rezulton i pa streh ,familje nje prinderore ne ngarkim me nje femije,eshte e perfshire ne programin e strehimit duke u trajtuar me bonus qiraje prej dy vitesh

Te dhena per apartamentin: apartamenti ndodhet ne banesen Nr 106 ne Fushe –Tepelene Zona kadastrale ( ZK) 3574 ne pronesi te EKB –se.Siperfaqe 31.07m2.

Ne shqyrtim te gjithe dokumentacionit te paraqitur, dhe ne mbeshtetje te ligjit nr 22/2018 ‘Per Strehimin Social,, ligjit 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore,, komisioni strehimit vlersoj se:

Merr parasysh kerkesen e Znj.Melisa Dulaj duke ja derguar te gjithe dokumentacionin bashkelidhur ketij RELACIONI, per marrje vendim nga Keshilli Bashkiak i Bashkise Tepelene.

**KOMISIONI**

Kryetar

Spiro Klor

anetar

Julinda Karteri

anetar

Muin Muca

anetar

Maksim Shehu

anetar

Armand Sala

Adresa: Sheshi “Lord Bajron” Tepelenë

web: [www.tepelena.gov.al](http://www.tepelena.gov.al)

E-mail: [info@tepelena.gov.al](mailto:info@tepelena.gov.al)

Nr. 151/1  
19-01-2024

KERKESE

DREJTUAR KRYETARIT BASHKISE TEPELENE

Ishtir - kur  
Jek streh  
J  
22.01.2024

Une e nenshkruara Melisa Admirim Dulaj e datelindjes 14.02.1995, banuese ne Bashkine Tepelene kerkon nga ana juaj te perfitoj nga programet e strehimit, ne baze te ligjit 22/2018 "Per strehimin Social", per arsye se jame ne kushte shume te veshtira ekonomike dhe e pa strehe( kjo e vertetuar pasi jam perfituese e programit te ndihmes ekonomike dhe bonusi i qirase).

I kerkon Bashkise Tepelene te me trajtoj me banese, pasi jame grua k/familjare me nje femije .

Ju falenderoj per mbeshtetjen qe me keni dhene deri tani dhe qendroj me shprese per kerkesen e mesiperme .

Duke ju falenderuar per mirekuptimin!

Tepelene, me 18.01.2024

Me respekt

Melisa Dulaj







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 51 / Prot

Tepelenë, më 19 / 01 / 2024

VERTETIM

Vërtetojmë se zonja Melisa Admirim Dulaj trajtohet me bonus qiraje në vlerën prej 6000 lek nga Bashkia Tepelenë për vitin 2023.

E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesën e të interesuarit.



KRYETARI

TËRMET PËCI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

VËRTETIM

“PËR LËSHIM VERTETIMESH (NEGATIV/POZITIV)”

Nga verifikimi I kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme ( ALBSCAD), rezulton se në emër të shtetasve:

Melisa Admirim Dulaj  
Orgest Mikel Shametaj

Në emërtësubjektevetesipercituarnukfigurojnëpasuritëregjistruaranëregjistrinelektroniktëpasurivetëpaluajtshme.

Lëshohet sipas kërkesës nr 2354, datë 25.10.2023.

DREJTORI

PËLLUMB MILORI

Elvana  
Elmazi

Digitally signed by:  
Elvana Elmazi  
Date: 2023.10.30  
03:41:55 +02'00'

Pellumb  
Milori

Digitally signed by:  
Pellumb Milori  
Date: 2023.10.30  
03:46:11 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Tepelenë  
Date: 2023/10/30 15:41:48 +02'00'  
J55214020W2023103015414024014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Tepelenë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TEPELENË-MEMALIAJ

SHKOLLA 9-VJEÇARE "AVNI RUSTEMI" TEPELENË

Nr. 534 --Prot.

Tepelenë, më 17.01.2024

### VËRTETIM

Vërtetojmë se nxënësi Orgest Mikel Shametaj lindur në Gjirokastrë më datë 23.04.2016, me Nr .Amze 7065( shtatë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) vazhdon klasën e II(dytë) në shkollën 9- vjeçare "Avni Rustemi" Tepelenë, në vitin shkollor 2023-2024.

E lëshoj këtë vërtetim për efekt dokumenti,

DREJTORI I INSTITUCIONIT ARSIMOR

MANJOLA PASKA



Adresa:Rruga" Bilbilenjtë",Tepelenë

email:shavnirustemii@gmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
GJIROKASTËR

A. J. ...

22.01.2024

Numri i Çështjes: [21001-00110-21-2021] 438

Data e Regjistrimit: 08/02/2021

Numri i Vendimit: [21-2022-275] 84

Data e Vendimit: 17/02/2022

V E N D I M  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR e përbërë nga:

GJYQTAR: BLERTA ÇIBUKU (MARKU)

Sekretare: ERVEHE TOSUNI

Sot, më datë: 17/02/2022, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket:

**Paditëse:** Mikel Shametaj, i biri Hektor dhe Tike, i datëlindjes 20.03.1985, lindur në Gjirokastrë dhe banues në fshatin Valare Gjirokastrë, përfaqësuar nga av. Çlirim Rabaj, anëtar i dhomës së avokatisë Gjirokastrë.

**E Paditur:** Melisa Dula, e bija e Admirim dhe Bukuroshe, e datëlindjes 14.02.1995, lindur në Gjirokastrë dhe banuese në fshatin Veliqot, Tepelenë.

**Objekti:** Zgjidhje martesës ligjore dhe pasojat sipas ligjit.

**Baza ligjore:** Nenet 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve rreth mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe pasi mori provat e paraqitura prej tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të të cilit, kërkuan:

**Paditësi:** -Pranimin e padisë, sipas kërtimeve të bëra, lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim paditësit

**E paditura:** zgjidhjen e martesës, dhe fëmijën kërkoj ta mbajë unë. dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi.

**VËREN**

Paditësi me kërkesë-padi i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e martesës me të paditurën.



Më datë 25.02.2016 është lidhur martesë midis paditësit dhe të paditures, fakt i provuar në gjykim me anë të certifikatës martesore të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Lunxhëri

Gjatë periudhës në vazhdimësi të kësaj martese kanë lindur, djalin Orgest Shametaj, i datelindjes 23.04.2016, fakt ky i provuar në gjykim me anën e certifikatës së përbërjes familjare të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Lunxhëri.

Fillimisht marrëdhëniet e tyre kanë qënë të mira dhe normale, por me kalimin e kohës filluan mosmarrëveshjet të cilat gradualisht u thelluan dhe tani marrëdhëniet janë tronditur thellë. Kanë një periudhë kohe që i kanë dhënë fund bashkëjetesës së tyre. Martesa mes tyre nuk funksionon, ajo e ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur dhe është zgjidhur në fakt, prandaj paditësi kërkon dhe zgjidhjen ligjrisht. Gjithashtu kërkon që femija i mitur të lihet në kujdestarinë e paditësit pasi për periudhën që martesa nuk funksionon "de facto" femija po qëndron pranë të paditurës dhe nuk e lejon të takohet me fëmijën. Gjithashtu prania e fëmijës pranë prindërve të paditurës do të ndikojë negativisht në rritjen dhe edukimin e tij, përse kohë që babai i të paditurës me vendim të gjykatës është i dënuar për veprën penale dhunë në familje. Kjo gjë nuk e siguron paditësin që babai i të paditurës të mos ushtrojë dhunë ndaj vetë asaj por edhe fëmijës së mitur.

Edhe pse nga gjykata janë bërë të gjitha përpjekjet që çështja të zgjidhet me pajtim, palët nuk arritën të gjenin mirëkuptimin ndërmjet tyre dhe ishin të vendosur për zgjidhjen e martesës. Ndodhur në këto kushte gjykata vlerësoi gjykimin e çështjes.

Nisur nga pretendimet e palëve në proces në seancën e veprimeve përgatitore të cilët u shprehën përpara gjykatës se nuk mund të zgjidhej çështja me pajtim midis tyre prandaj, gjykata në përputhje me nenin 135/2 të Kodit të Familjes vendosi të kalojë çështjen në seancë gjyqësore.

#### **Ligji i zbatueshëm:**

**Neni 1 Kodit të Familjes:** *"Martesa si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit të familjes".*

**Neni 2 i Kodit të Familjes:** *"Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës".*

**Neni 132 i Kodit të Familjes,** i përcaktuar si bazë ligjore e kërkimeve në këtë padi përcakton shprehimisht: *"Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët".*

**Neni 133 i Kodit të Familjes,** parashikon se: *"Gjykata vendos për fajësinë në zgjidhjen e martesës, vetëm kur ajo kërkohej prej njërit ose të dy bashkëshortëve".*

**Neni 146 i Kodit të Familjes,** jep këtë kuptim për të drejtën e përdorimit të mbiemrit të marrë pas martesë: *"Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës".*



**Neni 157 i Kodit të Familjes** përcakton se: Gjyqtari në këtë rast merr në konsideratë:

- a) marrëveshjen e bërë ndërmjet bashkëshortëve;
- b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij;
- c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën.

**Neni 158 i Kodit të Familjes** parashikon se: "Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës dhe për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet tij dhe ato të prindit tjetër. E drejta e vizitës dhe e banimit, sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t'i refuzohen, veçse për arsye të rënda që dëmtojnë interesat e fëmijës".

**Neni 201/2 i Kodit të Familjes** përcakton se: "Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet".

#### **Arsyetimi juridik:**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata veç marrjes së provave shkresore, që provonin lidhjen në martesë të paditësit dhe të paditurës, si dhe gjendjen familjare të tyre, lejoi marrjen e pohimeve prej palëve si dhe urdhëroi thirrjen e psikologes Anjeza Avduli për të dhënë mendimin në lidhje me aspektin e përshtatshmërisë, në lënien e fëmijës Orgest Shametaj për rritje dhe edukim.

Duke vlerësuar pohimet e palëve në raport me përmbajtjen e nenit 132 të Kodit të Familjes, Gjkata çmon se jetesa e përbashkët mes palëve ndërgjyqëse është bërë e pamundur dhe se martesa e ka humbur kuptimin dhe qëllimin e saj për të dy bashkëshortët.

Gjithashtu, në rrethanat kur palet nuk kërkuan që kjo martesë të zgjidhej për fajin e ndonjërit prej tyre, gjykata në përputhje me nenet 132 dhe 133 të Kodit të Familjes, çmon se martesa duhet zgjidhur pa faj të askujt.

Me zgjidhjen e martesës, gjykata rregullon edhe pasojat në lidhje me lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të lindur nga kjo martesë, detyrimin ushqimor ndaj tyre apo edhe të drejtën e takimit të prindit që nuk do i lihet fëmija për rritje dhe edukim.

Për të përcaktuar se ku është më e përshtatshme të jetoje fëmija Eugen Gjoka gjykata në përputhje me nenet 155 dhe 157 të Kodit të Familjes, mori mendimin e paditësit dhe të paditurës në seancë gjyqësore.

Gjithashtu pertej kesaj gjykata kërkoi dhënien e mendimit për këtë qëllim prej psikologes Anjeza Avduli.

Paditësi kërkoi në seancë gjyqësore që fëmija t'i lihet atij për rritje dhe edukim të vetë atij. Psikologja Anjeza Avduli, pasi u njoh me detyrat e dhëna nga gjykata, e dha mendimin e saj me shkrim në seancën gjyqësore të datës 31.01.2022 duke shprehur konkluzionet e mëposhtme:

Në bazë të informacioneve të marra nga intervistat klinike me palët, vëzhgimet sjellore, rezultojnë se martesa e çiftit Mikel Shametaj dhe Melisa Dulaj e ka humbur tashmë funksionin për të cilin është lidhur pavarësisht se të dy referojnë arsye të ndryshme për mosfunksionimin e marrëdhënies.

Çifti e ka zgjidhur faktikisht martesën prej disa muajsh dhe marrëdhënia bashkëprindërore nuk ekziston. Pala e paditur e percepton si të pa nevojshme ruajtjen e një marrëdhënie komunikimi me babain e fëmijës duke mos e perceptuar këtë gjë si detyrim që buron nga përgjegjësia prindërore për të ruajtur interesin më të lartë të zhvillimit të shëndetshëm të



fëmijës. Aia paditëse suprenet e gatshme për të vendosur një marrëdhënie bashkëprindërore efektive.

Gjatë muajve që faktikisht palët e kanë zgjidhur martesën i mituri ka jetuar me nënën dhe gjyshrit nga ana e nënës dhe nuk është lejuar të takoj të atin. Marrëdhënia mes të miturit dhe babait pas ndarjes faktike të palëve nuk është lejuar të zhvillohet në mënyrë të pavarur e pandikuar.

E paditura ka aftësi jo të mira në perceptimin llogjik të situatës (mendon se pas divorcit të prindërve fëmija duhet të qëndroj me njërin prind dhe nuk duhet ta takoj prindin tjetër, e shikon te pa nevojshme ruajtjen e një marrëdhënie bashkëprindërore), ka aftësi të varfra prindëruese (nuk arrin të identifikoj dhe menaxhoj emocionet e veta, nuk kupton nevojën e fëmijës për prezencën e figurës së babait në jetën e tij për një rritje dhe zhvillim të shëndetshëm si dhe ushtron presion dhe kërcënim emocional ndaj fëmijës duke i thënë në mënyrë të vazhdueshme se nëse ikën te babi nuk do ta takoj më mamën) gjithashtu shfaq aftësi të varfra për të marrë vendime për veten dhe fëmijën në mënyrë të pavarur nga babai i saj duke mos ju përgjigjur kështu në mënyrë të shëndetshme nevojave të fëmijës për stabilitet psiko-emocional, pamvarësi dhe hapsirë.

Nëna e të miturit nuk ka arritur të "shkëputet" nga familja e origjinës për të menduar dhe për të marrë vendime në mënyrë të pavarur si një person i rritur, për vete dhe për fëmijën. Vendimet për të paditurën dhe fëmijën e saj të mitur i merr babai i të paditurës.

Gjatë procesit të vlerësimit ndaj të miturit është ushtruar presion dhe kërcënim emocional nga nëna apo familjar të saj në marrëdhënie me figurën e ekspertit vlerësues duke ndërhyrë kështu dhe duke penguar procesin e vlerësimit.

Babi i të miturit ka aftësi të përshtatshme prindëruese, aftësi të mirë të perceptimit të situatës, identifikon dhe menaxhon shëndetshëm emocionet e tij ka një marrëdhënie shumë të mirë me të miturin dhe ju përgjigjet nevojave të tij.

Ndodhur në këto kushte, nisur nga sa më sipër, REKOMANDOJ:

Lënien e të miturit Orgest Shametaj për rritje dhe edukim babait të tij Z.Mikel Shametaj. Gjithashtu rekomandoj:

Takime të rregullta të nënes me fëmijën e mitur.

Angazhimin e nënës së të miturit për të rritur aftësitë e saj prindëruese dhe pamvarësinë e saj si individë në mënyrën e të vepruarit dhe të menduarit.

Duke vlerësuar pohimet e palëve ndërgjyqëse dhe mendimin e psikologes Anjeza Avduli, në raport me njëri-tjetrin, gjykata çmon se fëmija duhet t'i lihet për rritje dhe edukim të paditurës Melisa Dulaj.

\*Nga pohimet e paditësit dhe aktet e administruara në dosje rezultoi se ndërmjet palëve nuk ka ndonjë marrëveshje me shkrim për faktin se cilit prej tyre duhet t'i lihen për rritje dhe edukim fëmija e mitur, përkundrazi kanë pasur pretendime secila nga palët për të pasur përgjegjësinë prindërore.

\*Psikologja Anjeza Avduli në mendimin e dhënë me shkrim është shprehur se fëmija Orgest Shametaj duhet t'i lihet për rritje dhe edukim paditësit.

\*Interesi më i lartë i fëmijësve të mitur, në kuptim të nenit 2 të Kodit të Familjes, do të kërkonte domosdoshmërisht marrjen parasysh të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe të mendimit psikologjik, rrethana të cilat duke u vlerësuar në tërësinë e tyre, imponojnë dhënien e një vendimi në favor të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës.

Me lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim te paditures, gjykata në përputhje me nenet 158 dhe 201 të Kodit të Familjes, cakton edhe të drejtën e takimit për bashkëshortin



(paditësi), si dhe detyrimin e tij për ushqim ndaj fëmijës.

Duke patur parasysh moshën e fëmijës së mitur, nevojat e tij materiale në raport me këtë moshë, gjendjen ekonomike të secilës prej palëve ndërgjyqëse, pohimeve të palëve, në raport me përmbajtjen e neneve 158 dhe 201 të Kodit të Familjes, gjykata vlerëson se masa e detyrimit ushqimor për fëmijën e mitur duhet të jetë 8000 lekë në muaj.

Për sa i përket të drejtës së takimit të prindit me fëmijën që nuk i është lënë për rritje dhe edukim, gjykata në përcaktimin e periudhës së takimit merr parasysh moshën e fëmijës së mitur, nevojën e fëmijës për kujdesin e secilit prind, evitimin e pengesave në procesin e rritjes dhe edukimit të përshtatshëm të saj, rekomandimet e psikologes.

Duke marrë parasysh kriteret e mësipërme, gjykata çmon se e drejta e takimit e paditësit me fëmijën e mitur duhet të jetë çdo javë, ditën e premte nga ora 16:00 deri në ditën e diel nga ora 16:00, pushimet verore nga data 1 gusht deri në 20 gusht të çdo viti. Si dhe për festat e fundvitit nga data 24 dhjetor deri më 1 janar të çdo viti i mituri do të qëndrojë pranë paditësit Mikel Shametaj.

### **Konkluzioni:**

Për sa dhe si u arsyetua me sipër, gjykata çmon se padia është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar duke zgjidhur martesën sipas pasojave të përmendura më lart.

### **Për këto arsye**

Gjykata, bazuar në nenin 306 e 310 të K.Pr.Civile

### **VENDOSI**

- Zgjidhjen e martesës ligjore midis paditësit Mikel Shametaj dhe të paditurës Melisa Dulaj
- Lënien e fëmijës së mitur Orgest Shametaj për rritje dhe edukim të paditurës Melisa Dulaj.
- Detyrimin e paditësit Mikel Shametaj të paguajë pension ushqimor për fëmijën Orgest Shametaj në masën 8.000 (tetëmijë) lekë në muaj. Ky detyrim do fillojë të paguhet nga data e depozitimit të kërkesë padisë datë 08.02.2021
- Detyrimin e të paditurës Melisa Dulaj të lejojë paditësin Mikel Shametaj të takohet me fëmijën Orgest Shametaj, çdo javë, ditën e premte nga ora 16:00 deri ditën e diel ora 16:00, pushimet verore nga 1 gusht deri në 20 gusht të çdo viti. Si dhe për festat e fundvitit nga data 24 dhjetor deri më 1 janar të çdo viti i mituri do të qëndrojë pranë paditësit Mikel Shametaj.
- Urdhërohet Zyra e Kancelarisë së Gjykatës që vendimi pasi të marrë formë të prerë t'i dërgohet një kopje e tij Zyrës së Gjendjes Civile Lunxhëri.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.
- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Gjirokastrë, më 17.02.2022

SEKRETARE

ERVEHE TOSUNI

GJYQTARE

BLERTA CIBUKU (MARKU)

10x.66  
11.01.2024

Shtetërore dhe bashkiak  
D. J. J.

11.01.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE  
DEGA RAJONALE GJIROKASTËR

Nr. 02 Prot

Gjirokastrë më 09/01/2024

Lënda : Për miratimin e emrit të një familjeje përfituese

**BASHKISË**

**TEPELENË**

Në mbështetje të ligjit 22/2018 ' Për strehimin social' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij mbi zbatimin e programve të strehimit social dhe konkretisht mbi programin për banesat me kosto të ulët , pronë e EKB -Dega Rajonale Gjirokastrë , po Ju përcjellim kërkesën për miratimin nga ana e Juaj me Vendim të Këshillit Bashkiak të emrit të një familjeje përfituese për apartamentin me nr pasurie 22/42+1-18/1 ndodhur në ZK 3574 në banesën nr 106 në lagjen Fushë Tepelenë në qytetin e Tepelenes në vlerën 345.488 lekë .

Mbetemi në pritje të përcjelljes së një emri të një familjeje përfituese nga ana e Juaj me Vendim të Këshillit Bashkiak sipas dispozitave që dikton ligji 22/2018 ' Për strehimin social' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për apartamentin e sipërcituar .

Bashkangjitur , ( Çertifikata e pronësisë , formulari nr 10 , planvendosje )

Me konsideratë,

**DREJTOR I DËGËS**

**Florian HYSAJ**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHITETËRORE E KADASTRËS

# CERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

| PRONARI/BASHKËPRONARËT                      |                   |            |
|---------------------------------------------|-------------------|------------|
| Emri i Personit Juridik                     | Nr. Personal NIPT | Pjesa(-/-) |
| DR RAJ ENTI KOMBETAR BANESAVE<br>GJIROKASTE | K43522606W        | 1/1        |

|                            |                                         |           |             |
|----------------------------|-----------------------------------------|-----------|-------------|
| Numri i Pasurisë           | 22/42+1-18/1                            |           |             |
| Kodi Unik                  | 3574024132                              |           |             |
| Zona Kadastrale            | 3574                                    |           |             |
| Lloji i Pasurisë           | APARTAMENT                              |           |             |
| Sipërfaqja e pasurisë (m2) | Totali: 31.07                           | Truall: 0 | Ndërtesë: 0 |
| Vlera Aktuale e Pasurisë   | 1                                       |           |             |
| Adresa e Pasurisë          | TEPELENE, TEPELENE, Rr.: FUSHE TEPELENE |           |             |

DREJTORI

Pëllumb Milori

Pëllumb

Milori

Digitally signed by:

Pëllumb Milori

Date: 2023.06.02

10:51:21 +02'00'

Data e lëshimit 02/06/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Tepelenë  
Date: 2023/06/02 10:50:35 +02'00'  
K43522606W2023060210502851L101

ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

FORMULARI NR. 1

LLOGARITJA E VLERËS SË APARTAMENTIT.

Banesa \_\_\_\_\_ 106 \_\_\_\_\_

Qytetari \_\_\_\_\_

Viti i ndertimit \_\_\_\_\_ 1996 \_\_\_\_\_

1. KOSTO E APARTAMENTIT.

a) kosto për 1 m2 sipërfaqe e shfrytëzimit të apartamentit

\_\_\_\_\_ 15049.919 \_\_\_\_\_

b) sipërfaqe e apartamentit

\_\_\_\_\_ 31.07 \_\_\_\_\_

c) kosto e apartamentit në lekë (a x b)

\_\_\_\_\_ 405461 \_\_\_\_\_

ç) Vlera e amortizimit të llogaritur

\_\_\_\_\_ 32000 \_\_\_\_\_

d) , vlera e apartamentit (1c-1ç)

\_\_\_\_\_ 323461 \_\_\_\_\_

d) vlera e apartamentit të rivlerësuar me VKB nr. date, prot. nr. date

2. KOSTO PER SHPENZIME OPERACIONALE.

a) shpenzime operacionale 4% , e cila paguhet në mënyrë të menjëhershme

\_\_\_\_\_ 12938 \_\_\_\_\_

3. VLERË E TRUALLIT TË APARTAMENTIT.

a) koeficienti i llogaritjes së sipërfaqes së truallit

\_\_\_\_\_ 0.32 \_\_\_\_\_

b) sipërfaqe e apartamentit

\_\_\_\_\_ 31.07 \_\_\_\_\_

c) sipërfaqe e truallit që i takon apartamentit

\_\_\_\_\_ 9.94 \_\_\_\_\_

d) çmimi i truallit për 1 m2

\_\_\_\_\_ 1015 \_\_\_\_\_

e) vlera e truallit (c x d)

\_\_\_\_\_ 10089 \_\_\_\_\_

4. VLERË E APARTAMENTIT (1+2+3)

\_\_\_\_\_ 346488 \_\_\_\_\_

Data ...12.07.2021

Llogaritjet u kryen nga: 1. Sp. Andon Goci

2. \_\_\_\_\_







9

|     |     |
|-----|-----|
| 380 |     |
| 25  | 356 |
| 68  | 425 |
|     | 110 |


# PLANI I KATIT TE KATERT E TE PESTE SHK. 1=100




|     |    |    |     |     |     |
|-----|----|----|-----|-----|-----|
| 140 | 38 | 92 | 469 | 120 | 110 |
| 140 | 38 |    | 356 |     |     |
| 179 |    |    | 380 | 25  |     |



## PLANI I KATIT TE SHKALLVE PER PJESEN MBITARRACEN E GODINES SHK. 1=100



|           |                                               |
|-----------|-----------------------------------------------|
| BA        | BANESA NR: 104 ÷ 105, 106<br>DHG 107 TEPELENE |
| TEPELENE  | PLANI I KATIT TE KATERT E PESTE               |
| A-04      | PERGJEGJESI L. HYSENI                         |
| POROSITES | AUTOR L. HYSENI                               |
| N. R. SH. | PERPUJDI L. HYSENI                            |
| KOMUNALE  | - " - A. GJERGJI                              |
|           | VIZATOI V. KRISTO                             |







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

TEPELENË

Nr. \_\_\_\_\_.

Tepelenë më, \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**P/V E N D I M**

Nr \_\_\_\_ .Datë. \_\_\_\_ .02.2024

**“MIRATIMIN NË PARIM TË RRUGËS SË KALIMIT (SERVITUT) PUBLIK, NDODHUR NË FSHATIN LUZAT, ZONA KADASTRALE NR. 2541 PASURIA NR.401/22, SIPAS PLANVENDOSJES”**

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar; Dokumenteve të paraqitura, si dhe Propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin në parim të Rrugës së kalimit (Servitut) Publik, ndodhur në Fshatin Luzat, Zona Kadastrale nr. 2541, pasuria nr.401/22, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

**Jurist**

**Julinda Karteri**

**KRYETAR**

**Arben Gumeni**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË

Tepelenë më, 19.02.2024

**RELACION**

“Miratimin në parim të rrugës së kalimit (servitut) publik, ndodhur në fshatin luzat, zona kadastrale nr. 2541 pasuria nr.401/22, sipas planvendosjes”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar; Dokumenteve të paraqitura, kërkesave të subjektit "UJI I FTOHTË TEPELENE" Shpk për rrugë kalimi drejtuar këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë, me numër prot.1152 datë 07.07.2023 protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr.1411 datë 10.07.2023 dhe nr.1158 datë 10.07.2023 protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr.1423 datë 11.07.2023.

**PROPOZOJMË:**

Miratimin në parim të Rrugës së kalimit (Servitut) Publik, ndodhur në Fshatin Luzat, Zona Kadastrale nr. 2541, pasuria nr.401/22, sipas planvendosjes bashkëlidhur.

Grupi i Punës:

1. Maksim Shehu

2. Gëzim Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

Tepelenë më, 19.02.2024

### **PROPOZIM**

“MIRATIMIN NË PARIM TË RRUGËS SË KALIMIT (SERVITUT) PUBLIK, NDODHUR NË FSHATIN LUZAT, ZONA KADASTRALE NR. 2541 PASURIA NR.401/22, SIPAS PLANVENDOSJES”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligj in nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar; Dokumenteve të paraqitura, kërkesave të subjektit “UJI I FTOHTË TEPELENE” Shpk për rrugë kalimi drejtuar këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë, me numër prot.1152 datë 07.07.2023 protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr.1411 datë 10.07.2023 dhe nr.1158 datë 10.07.2023 protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr.1423 datë 11.07.2023.

### **PROPOZOJ:**

Miratimin në parim të Rrugës së kalimit (Servitut) Publik, ndodhur në Fshatin Luzat, Zona Kadastrale nr. 2541, pasuria nr.401/22, sipas planvendosjes bashkëlidhur.



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: BASHKIA TEPELENE

DATE : 23/02/2024

QELLIMI: RRUGE PER SERVITU KALIMI

VENDNDODHJA:

BASHKIA TEPELENE

DVAKSH/ZVAKSH

ZONA KADASTRALE : 3574

NUMURI PASURISE :401/1

INDEKS HARTE: TP-L-8

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE : KULLOTE


SIP.PAS = 1710 m<sup>2</sup>

SIP. GJURMES NDERTIMIT= m<sup>2</sup>

NR. KATEVE

NR.PEMEVE

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SHK. 1:2500

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|-----|-----------|-----------|--------------|----------|---------|------------------------|
| 1   | VERIU     |           | KUFI TOKESOR |          |         |                        |
| 2   | JUGU      |           |              |          |         |                        |
| 3   | LINDJA    |           |              |          |         |                        |
| 4   | PERENDIMI |           |              |          |         |                        |

### REALIZOI PER BASHKINE TEPELENE

EMRI: MAKSIM SHEHU

LICENCA NR. T0025/3, DT:21.06.2017

NENESHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENESHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE : Z- Zyre

PERCAKTIMI I KUFIRIT : HK- Harta Kadastrale

SHENIME TE VECANTA: PNR.401/22-A ME SIP =1710 m<sup>2</sup> PROPOZOHET PER RRUGE SI SERVITU KALIMI

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIMI MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI : BASHKIA TEPELENE

NENESHKRIMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA TEPELENË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 258/lprot.

Tepelenë, më 07.02.2024

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_. \_\_. 2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 15, DATË 27.02.2020, TË KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli bashkiak,

**PROPOZON:**

1.Në tekstin “Për miratimin e Rrgullores së Brendshme të Këshillit Bashkiak Tepelenë”, të miratuar me VKB-në nr.15, datë 27.02.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**Neni 33**

**Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm**

Këshilli i Bashkisë ka **6 (gjashtë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

- 1.1 Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve 3(tre) anëtere/ë.
- 1.2 Komisioni i Financave Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, 3(tre) anëtere/ë.
- 1.3 Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, 3(tre) anëtere/ë

1.4 Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit 3(tre) anëtare/ë.

1.5 Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve si Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, Komisioni për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European 3(tre) anëtere/ë.

**1.6 Komisioni i integritimit evropian, 3 anëtare/ë. (të bëhet shtesë pasi të miratohet ndryshimi i rregullores)**

Komisioni i integritimit evropian të përbëhet nga tre (3) këshilltarë, dy nga shumica dhe një nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë “Pro” shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë gjinore. Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

Komisionit i integritimit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritimit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritimit European, organizon në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETARI I KËSHILLIT**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA TEPELENË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.258/1 prot.

Tepelenë, më 07.02.2024

**RELACION SQARUES**

Nr. \_\_\_\_, datë \_\_.\_\_.2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 15, DATË 27.02.2020, TË KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, lligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” vendosëm të bëhen këto shtesa dhe ndryshime me miratimin e këshillit,

Në tekstin “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit Bashkiak Tepelenë”, të miratuar me VKB-në nr.15, datë 27.02.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**Neni 33**

**Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm**

Këshilli i Bashkisë ka **6 (gjashtë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

- 1.1 Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve 3(tre) anëtare/ë.
- 1.2 Komisioni i Financave Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, 3(tre) anëtare/ë.
- 1.3 Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, 3(tre) anëtare/ë
- 1.4 Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit 3(tre) anëtare/ë.

1.5 Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve si Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, Komisioni për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian 3(tre) anëtare/ë.

#### **1.6 Komisioni i integritit evropian, 3 anëtare/ë.**

Komisioni i integritit evropian të përbëhet nga tre (3) këshilltarë, dy nga shumica dhe një nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë "Pro" shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë gjinore. Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

*Komisionit i integritit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :*

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritit Evropian, organizon në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qëndrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

#### **SEKRETAR I KËSHILLIT**





Në zbatim të Ligjit 139/2015 Për Vërtetësishtjen Vendore të ndryshuar si dhe të gjithë legjislacionit të miratuar nga Këshilli Bashkiak rekomandohen ndryshimet e mëposhtme në rregulloren e Këshillit Bashkiak si më poshtë

#### **Kreu**

**Organizimi dhe Struktura e Këshillit Bashkiak, neni .., Emërtimi i Komisioneve të Përhershme të shtohet një pikë që përcakton ngritjen e Komisionit të Integrimit Evropian.**

*Misioni Komisionit të Integrimit Evropian.*

1. Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE. Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
2. Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
3. Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë me mbështetjen e strukturës së Integrimit Evropian organizojnë në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-së.
4. Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-së, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
5. Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.239/9 prot.

Tepelenë, më 20.02. 2024

**PROJEKTVENDIM**

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHEM TË KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË, SIPAS RREGULLORES SE BRENDSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË”**

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma “a”, “Zgjedh nga perberja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të këshillit të vet”, si dhe në zbatim të, “Rregullores së brendshme të Këshillit Bashkiak Tepelenë”, neni 29, “Komisionet e këshillit”, pika 2, neni 30, “Komisionet e përherëshme të këshillit”, pika 1, neni 31 “Ngritja dhe përberja e komisioneve të përherëshme”, pika 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12, neni 33,

**V E N D O S I**

1. Të miratoje ngritjen e komisioneve të përherëshme të këshillit të Bashkisë Tepelenë, me përbërjen si më poshtë:
  - 1.1 Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve do të ketë në përberjen e tij 3(tre) anëtarë si më poshtë:
    - Ditar Hodaj Kryetar
    - Miftar Meta N/Kryetar
    - Ilir Haska Anëtar
  - 1.2 Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit,



Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, do të ketë në përberjen e tij 3(tre) anëtarë si më poshtë:

- Matilda Çela Kryetare
- Latif Kaçaj N/ Kryetar
- Vladimir Gjonça Anëtar

1.3 Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut do të ketë 3(tre) anëtarë si më poshtë:

- Mirela Varfi Kryetare
- Marsela Balili N/Kryetare
- Marios Jorgo Anëtar

1.4 Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit do të ketë në përberjen e tij 3(tre) anëtarë si më poshtë:

- Ilir Haska Kryetar
- Esmeralda Bishani N/Kryetare
- Ditar Hodaj Anëtar

1.5 Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve si Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, do të ketë në përberjen e tij 3(tre) anëtarë si më poshtë:

- Mirela Varfi Kryetare
- Besnik Maça N/Kryetar
- Vladimir Bakiaj Anëtar

1.6 Komisioni i integritetit europian dhe mardhëniet me jashtë, do të ketë në përbërjen e tij 3 anëtare/ë si më poshtë.

- Matilda Cela Kryetare
- Vladimir Bakiaj N/Kryetar
- Ilir Haska Anetar

2. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 60 datë, 29.06.2023 shfuqëzohet
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Tepelenë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**JURISTI**  
**JULINDA KARTERI**

**KRYETAR**  
**ARBEN GUMENI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

### RELACION

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar të nenit 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma "a", "Zgjedh nga perberja e vet komisionet e keshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të këshillit të vet", si dhe në zbatim të "Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë", neni 29 "Komisionet e këshillit", neni 30 "Komisionet e përhershme të këshillit", neni 31 "Ngritja dhe pëberja e komisioneve të përhershme", neni 33 pika 14, propozon ngritjen e komisionit për marrëdhëniet me jashtë dhe integrimin evropian në Këshillin Bashkiak Tepelenë.

#### *Misioni I të cilit është:*

1. Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE. Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
2. Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritetit evropian cili hartohet dhe raportohet cdo vit kalendarik.
3. Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë me mbështetjen e strukturës së Integritetit Europian organizojnë në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-së.
4. Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-së, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
5. Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritetit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

**Sekretare Këshillit**

**Valbona Çela** 

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: [www.tepelena.gov.al](http://www.tepelena.gov.al) E-mail: [info@tepelena.gov.al](mailto:info@tepelena.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr.239/6.prot.

Tepelenë më,.....2024

**P/V E N D I M**

Nr. , datë .....2024

**“PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURËS NGA BASHKIA TEPELENË PËR  
CAKTIMIN E VENDPARKIMEVE DHE VENDOSJES SË SINJALISTIKËS NË QYTETIN  
TEPELENË**

Bazuar në: nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” pika 1/1.3 dhe pika 1/1.6; neni 23 pika 4, nenin 36, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërorë që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; VKB nr.92, datë 25.11.2022, “Për miratim të Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë” me gjithë ndryshimet; “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” me gjithë ndryshimet; interesit të përbashkët për gjithë komunitetin në Bashkinë Tepelenë

**VENDOSI**

1. Të miratojë nisjen e procedurës nga Bashkia Tepelenë për caktimin e vendparkimeve dhe vendosjes së sinjalistikës në qytetin Tepelenë.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Tepelenë, Drejtoria e Ligjore dhe Sherbimet Orgnizative, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe për zbatimin e këtij vendimi



3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Gjirokastrë.

**JURISTI**

**-JULINDA KARTERI**



**KRYETAR**

**ARBEN GUMENI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr .....Prot

BASHKIA TEPELENË

Tepelenë më, .....2024

### RELACION

#### PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURËS NGA BASHKIA TEPELENË PËR CAKTIMIN E VENDPARKIMEVE DHE VENDOSJES SË SINJALISTIKËS NË QYTETIN TEPELENË

Bazuar në: nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" pika 1/1.3 dhe pika 1/1.6; neni 23 pika 4, nenin 36, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; VKB nr. 92, datë 25.11.2022, "Për miratim të Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë" me gjithë ndryshimet; "Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" me gjithë ndryshimet; interesit të përbashkët për gjithë komunitetin në Bashkinë Tepelenë

### PROPOZOJ

1. Miratimin e nisjes së procedurës nga Bashkia Tepelenë për caktimin e vendparkimeve dhe vendosjes së sinjalistikës në qytetin Tepelenë

Drejtoria Juridike

Julinda Karteri

Drejtoria e Financës

Spiro Kora

Adresa: Sheshi "Lord Bajron" Tepelenë

web: [www.tepelena.gov.al](http://www.tepelena.gov.al)

E-mail: [info@tepelena.gov.al](mailto:info@tepelena.gov.al)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 239/16 Prot

BASHKIA TEPELENË

Tepelenë më 29.02.2024

PROPOZIM

PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURËS NGA BASHKIA TEPELENË PËR CAKTIMIN E VENDPARKIMEVE DHE VENDOSJES SË SINJALISTIKËS NË QYTETIN TEPELENË

Bazuar në: nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" pika 1/1.3 dhe pika 1/1.6; neni 23 pika 4, nenin 36, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; VKB nr. 92, datë 25.11.2022, "Për miratim të Paketës Fiskale të Bashkisë Tepelenë" me gjithë ndryshimet; "Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" me gjithë ndryshimet; interesit të përbashkët për gjithë komunitetin në Bashkinë Tepelenë

PROPOZOJ

Miratimin e nisjes së procedurës nga Bashkia Tepelenë për caktimin e vendparkimeve dhe vendosjes së sinjalistikës në qytetin Tepelenë

JURIST

Julinda Karteri

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr 239 Prot

Tepelenë, më 06.02 2024

**P/ V E N D I M**

**P Ë R**

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2023**

Këshilli i Bashkisë Tepelenë në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar për zbatimin e buxhetit të Bashisë Tepelenë për vitin 2023, mbështetur në:

- Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetqëverisjen vendore ”,
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 « Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë », i ndryshuar
- Ligji nr 10296 datë 8.7.2010 « Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar »
- Ligji 68/2017 2010 « Për financat e vetëqeverisjes vendore » Neni 51
- V.K.B Nr. 95 datë 17.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023“i ndryshuar

**V E N D O S I:**

1.Të miratoje Raportin Vjetor të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2023 i cili është i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor 2023 dhe përfshin ;

- a) Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2023
- b) Pasqyrat Financiare të vitit 2023
- c) Raportin mbi zbatimin e rekomadimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.



2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik & Menaximit Financiar

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr 139/2015 « Për vetëqeverisjen vendore », të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Drejtori Juridike

Julinda Karteri

Drejtori Finances

Spiro Kora

KRYETARI  
Arben Gumeni

# **BASHKIA TEPELENE**

**DREJTORIA E ZHVILIMIT EKONOMIK & MENAXHIMIT FINANCIAR**

## **RELACION**

**PER**

**ZBATIMIN E BUXHETIT**

**VITI 2023**

- ✓ **RAPORT I MONITORIMIT BUXHETIT 2023**
- ✓ **PASQYRAT FINANCIARE 2023**
- ✓ **ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TE KLSH**



## ❖ **RAPORT I MONITORIMIT BUXHETIT 2023**

### **Funksioneve kryesore te veprimtarise se Bashkise :**

- Ne fushen e infrastructures dhe sherbimeve publike
- Sherbimet sociale
- Fusha e kultures ,Sportit sherbime argetuese.
- Fusha e mbrojtjes mjedisit.
- Fusha e Bujqesise,Zhvillimit Rrural,Pyje,Kullota,Mjedisi e Biodiversiteti.
- Fusha e zhvillimit ekonomik.
- Fusha e sigurise Publike.

Ne permbushjen e funksioneve te mesiperme eshte drejtuar dhe zbatimi I buxhetit te bashkise miratuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr 95 date 25.11.2022 “Per mieratimin e buxhetit te vitit 2023 “ I ndryshuar

Fokusimi ne nje rritje cilesore te nivleit te sherbimeve ne komunitet,ne mirembajten e institucioneve shkollore e zhvillimin e kultures e sportit ne konsolidimin fiskal e financiar ku prioritet do te jete zgjerimi I bazes te tatimpaguesve dhe shlyerja e nje pjese te konsiderueshme te detyrimeve te viteve kaluar ishin objektivat kryesore te buxhetit te vitit 2023

**Shperndarja dhe perdorimi ekonomik I burimeve financiare, transparenca, pergjegjesia dhe respektimi me rigorozitet I buxhetit, jane parimet kryesore qe Bashkia Tepelene merr parasysh ne zbatimin e buxhetit**

Njesite e veteqeverisjes vendore kryejene shpenzime sipas akteve ligjore e e nenligjore ne fuqi ne perputhje me parimet e disiplines fiskale ,menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe perdorimin me eficence,efektivitet e ekonomi te burimeve te tyre finaciare.

❖ **TREGUESIT EKONOMIKO -FINANCIAR**

| NR | VITET | BUXHETI | REALIZIMI |
|----|-------|---------|-----------|
| 1  | 2016  | 168.721 | 146.525   |
| 2  | 2017  | 188.459 | 182.350   |
| 3  | 2018  | 192.000 | 174.198   |
| 4  | 2019  | 206,101 | 195,464   |
| 5  | 2020  | 207,403 | 199,492   |
| 6  | 2021  | 223,566 | 219,213   |
| 7  | 2022  | 276,032 | 252,034   |
| 8  | 2023  | 293,002 | 273,053   |

❖ **NUMRI TE PUNESUARVE**

|      |            |
|------|------------|
| 2016 | <b>210</b> |
| 2017 | <b>225</b> |
| 2018 | <b>240</b> |
| 2019 | <b>245</b> |
| 2020 | <b>235</b> |
| 2021 | <b>235</b> |
| 2022 | <b>235</b> |
| 2023 | <b>235</b> |

❖ **REALIZIMI I TREGUESVE KRYESOR PER VITIN 2023**

| Nr | Emertimi                  | Plan Fillestar | Plani Ndryshuar | Realizimi   | %           |
|----|---------------------------|----------------|-----------------|-------------|-------------|
| 1  | Te ardhurat te veta       | 60,000,000     | 60,000,000      | 46,602,469  | <b>77,6</b> |
| 2  | Shpenzimet e pergjithshme | 262,691,000    | 293,001,811     | 273,053,415 | <b>93,2</b> |

**Po cilat jane parimet mbi te cilat jemi mbeshtetur per nje Administrim te mire te Kopetencave Fiskale ?**

- **Përputhshmëria:** pagesat e përdoruesve janë të njëjta me kostot e shërbimeve;
- **Drejtësia:** ngarkesa fiskale bazohet në aftësinë për të paguar;
- **Neutraliteti:** ngarkesa nuk duhet të ndikojë në eficiencën e shpërndarjes së burimeve në sektorin privat; taksat nuk duhet të favorizojnë apo diskriminojnë një grup tatimpaguesish kundrejt një tjetri;
- **Përgjegjshmëria:** duhet të jetë e qartë se sa duhet të paguajnë tatimpaguesit dhe si do të përdoren këto fonde nga bashkia;
- **Përshtatshmëria dhe stabiliteti:** të ardhura të mjaftueshme për të financuar shërbimet në mënyrë të vazhdueshme; të ardhurat duhet të jenë të parashikueshme dhe të qëndrueshme ndër vite;
- **Autonomia;** bashkitë duhet të kenë autonomi dhe fleksibilitet për të vendosur prioritetet e tyre;
- **Minimizimi i kostove administrative:** llogaritja, vlerësimi, mbledhja dhe administrimi i taksave apo tarifave nuk duhet të konsumojë kohe, resurse dhe energji të tepërta;
- **Thjeshtësia:** detyrimi tatimor duhet të kuptohet lehtësisht, ndërkohë që përjashtimet duhet të kufizohen vetëm për raste tepër specifike dhe me një arsye të qartë;

**Cili eshte perkufizimi ligjor I takasave e tarifave ?**

- **Taksë vendore:** është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e bashkisë, e vendosur me ligj, dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e bashkisë;
- **Tarifë vendore:** është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur, apo të drejte të dhënë nga bashkia;
- **Niveli i tarifave vendore orientohet drejt kostos së ofrimit të shërbimit;**



- ❖ Në hartimin e buxhetit vjetor, jemi bazuar në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme;

**TRANSFERTA NGA BUXHETI I SHTETIT;**

| Nr | Emertimi                  | Viti 2021      | Viti 2022      | Viti 2023      |
|----|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| 1  | Transferte e pakushtezuar | 86,250         | 92,777         | 121,376        |
| 2  | Transferta specifike      | 81,329         | 84,471         | 104,748        |
|    | <b>Totali</b>             | <b>167,579</b> | <b>177,248</b> | <b>226,124</b> |

**TE ARDHURAT E VETA**

| Nr | Viti                                | Plani         | Realizimi     | Deviacioni     | %           |
|----|-------------------------------------|---------------|---------------|----------------|-------------|
|    | <b>Bashkia Tepelene</b>             |               |               |                |             |
| 1  | 2016                                | 36,000        | 23,685        | -12,315        | 65.8        |
| 2  | 2017                                | 36,000        | 39,235        | 3,235          | 108.9       |
| 3  | 2018                                | 40,000        | 40,617        | 617            | 101.5       |
| 4  | 2019                                | 45,438        | 35,708        | -9,730         | 78.5        |
| 5  | 2020                                | 42,500        | 37,591        | -4,909         | 88.4        |
| 6  | 2021                                | 52,500        | 55,280        | 3,280          | 105.3       |
| 7  | 2022                                | 62,000        | 52,313        | -9,687         | 84.3        |
| 8  | <b>2023</b>                         | <b>60,000</b> | <b>46,602</b> | <b>-13,398</b> | <b>77.7</b> |
|    | <b>Njesia Qyteti Tepelene</b>       |               |               |                |             |
| 1  | 2016                                | 18,000        | 14,312        | -3,688         | 79.5        |
| 2  | 2017                                | 18,132        | 30,402        | 12,270         | 167.6       |
| 3  | 2018                                | 22,654        | 32,483        | 9,829          | 143         |
| 4  | 2019                                | 27,438        | 24,155        | 283            | 99          |
| 5  | 2020                                | 28,336        | 28,699        | 363            | 101.2       |
| 6  | 2021                                | 38,666        | 46,465        | 7,799          | 120         |
| 7  | 2022                                | 47,836        | 43,398        | -4,438         | 90.7        |
| 8  | <b>2023</b>                         | <b>43,608</b> | <b>35,682</b> | <b>-7,926</b>  | <b>81.8</b> |
|    | <b>Njesia Administrative Qender</b> |               |               |                |             |
| 1  | 2016                                | 9,500         | 6,238         | -3,262         | 65.6        |
| 2  | 2017                                | 9,400         | 5,931         | -3,469         | 63          |

|   |                                        |              |              |               |             |
|---|----------------------------------------|--------------|--------------|---------------|-------------|
| 3 | 2018                                   | 8,655        | 5,604        | -3,051        | 64.7        |
| 4 | 2019                                   | 9,500        | 5,708        | -3,792        | 60          |
| 5 | 2020                                   | 6,724        | 5,042        | -1,682        | 75          |
| 6 | 2021                                   | 6,724        | 5,628        | -1,096        | 83,7        |
| 7 | 2022                                   | 6,724        | 5,402        | -1,322        | 80,3        |
| 8 | <b>2023</b>                            | <b>8,614</b> | <b>6,178</b> | <b>-2,436</b> | <b>71,7</b> |
|   | <b>Njesia Administrative Kurvelesh</b> |              |              |               |             |
| 1 | 2016                                   | 5,000        | 2,079        | -2,921        | 41.5        |
| 2 | 2017                                   | 4,960        | 1,773        | -3,187        | 35.7        |
| 3 | 2018                                   | 4,648        | 1,357        | -3,291        | 29.1        |
| 4 | 2019                                   | 5,000        | 1,658        | -3,342        | 33          |
| 5 | 2020                                   | 4,246        | 2,279        | -1,967        | 53.7        |
| 6 | 2021                                   | 4,246        | 1,702        | -2,544        | 40          |
| 7 | 2022                                   | 4,246        | 1,851        | -2,394        | 43,6        |
| 8 | <b>2023</b>                            | <b>4,250</b> | <b>2,816</b> | <b>-1,434</b> | <b>66,2</b> |
|   | <b>Njesia Administrative Lopes</b>     |              |              |               |             |
| 1 | 2016                                   | 3,500        | 968          | -2,532        | 26.7        |
| 2 | 2017                                   | 3,460        | 1,129        | -2,331        | 32.6        |
| 3 | 2018                                   | 3,313        | 1,172        | -2,141        | 35.3        |
| 4 | 2019                                   | 3,500        | 1,188        | -2,312        | 33.9        |
| 5 | 2020                                   | 3,194        | 1,571        | -1,623        | 49          |
| 6 | 2021                                   | 3,194        | 1,485        | -1,709        | 46,5        |
| 7 | 2022                                   | 3,194        | 1,663        | -1,531        | 52          |
| 8 | <b>2023</b>                            | <b>3,528</b> | <b>1,926</b> | <b>-1,602</b> | <b>54,6</b> |

Per vitin 2023 nga mos realizimi I te ardhurave nga Njesite Administrative kane munguar buxhetit te Bashkise ; - **-13,398,000 leke**

Per periudhen 2016-2023 buxhetit te Bashkise I kane munguar - **82,019,000 lek**

❖ **Detyrimet debitore ne fund te vitit 2023**

| SUBEKTI | NR  | DETYRIMI  | PAGUAR | SHUMA     | PA<br>PAGUAR | SHUMA   |
|---------|-----|-----------|--------|-----------|--------------|---------|
| SHPK    | 112 | 5.518.000 | 52     | 4.873.350 | 60           | 644.650 |

|              |     |            |     |           |     |           |
|--------------|-----|------------|-----|-----------|-----|-----------|
| INSTITUCIONE | 15  | 379.680    | 12  | 325.070   | 3   | 54.610    |
| P. FIZIK     | 376 | 6.227.000  | 172 | 4.278.219 | 204 | 1.948.781 |
| TOTAL        | 503 | 12.124.680 | 236 | 9.476.639 | 267 | 2.648.041 |

Kontratat e tokave bujqesore/pyje kullota.

Ne total jane lidhur 85 kontrata me vlere 7.615.698 leke

Nga te cilat jan likujduar 61 kontrata me vlere 6.263.845 leke.

Ngelen debitor 24 kontrta me vlere 1.351.853 leke

Debitore nga viti 2020-2022 jane 25 kontrata me vlere 3.229.607 leke

Nga mos realizmi i te ardhura nga subjektet publike,juridike e fizike i kane munguar buxhetit te bashkise deri ne fund te vitit 2023 - 20,243,893 leke. Nga keto vetem per vitin 2023 ne Shumen - 2,648,041 leke

▪ **Kerkesat buxhetore per vitin 2023 permbajne;**

▪ **Misionin e Bashkise**

- Vetëqeverisja vendore siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
- Pershkrimin e programeve buxhetore
- Planifikimin e shpenzimeve per cdo program ,sipas artikujve,produkteve dhe aktiviteteve
- Treguesit faktik per vitin buxhetor paraardhes,treguesit e planifikuar per vitin buxhetor ne vazhdim dhe per tre vitet e ardheshme.



### SHPENZIMET VITIT 2023

| Nr | Emertimi                   | Buxheti        | Realizimi      | %           |
|----|----------------------------|----------------|----------------|-------------|
| 1  | Paga                       | 154,176        | 150,490        | 97,6        |
| 2  | Sigurime shoqerore         | 15,676         | 14,638         | 93,4        |
| 3  | Shpenzime operative        | 97,844         | 94,572         | 96,6        |
| 4  | Transferta te Futboll Klub | 5,080          | 3,551          | 69,9        |
| 5  | Transferta te individeve   | 6,120          | 5,677          | 92,8        |
| 6  | Shpenzime kapitale         | 14,106         | 4,125          | 29,3        |
|    | <b>TOTALI</b>              | <b>293,002</b> | <b>273,053</b> | <b>93,2</b> |

### Struktura e shpenzime te realizuara per vitin 2022

| Nr | Emertimi                   | Realizimi      | %          |
|----|----------------------------|----------------|------------|
| 1  | Paga                       | 150,490        | 55,1       |
| 2  | Sigurime shoqerore         | 14,638         | 5,4        |
| 3  | Shpenzime operative        | 94,572         | 34,6       |
| 4  | Transferta te Futboll Klub | 3,551          | 1,3        |
| 5  | Transferta te individeve   | 5,677          | 2,1        |
| 6  | Shpenzime kapitale         | 4,125          | 1,5        |
|    | <b>TOTALI</b>              | <b>273,053</b> | <b>100</b> |

Peshen kryesore ne buxhetin e vitit 2023 e ka zene kosto e punes ( paga + sigurime shoqerore ) ne masen 60,5 % . rritur me 4,2 pike % ne krahasim me nje vit me pare

Po ashtu gjate vitit 2023 jane likujduar detyrime te prapambetura per mallra e sherbime ne shumen 16,500 mije leke ose 17,4 % te totalit te shpenzimeve operative te kryera gjate vitit 2023

Vend te rendesishem ne buxhetin e vitit 2023 ze ana sociale e tij per kete vit per buxhetet familjare jane shpenzuar 5,677,000 leke

1. Ndhme ekonomike nga buxheti pavarur .....2,230,000 leke
2. Mbeshteje financiare familjeve e individeve ne nevoje .... 3,015,000 leke
3. Bonus qiraje ..... 432,020 leke

Transferta te Futboll Klub TEPELENA ne Shumen 3,500,000 leke

Efetkte e rritjes se pages minimale nga 34,000 leke ne 40,000 leke per vitin 2023 zene Shumen 4,320,000 leke ku perfituan rreth 80 punonjes.

## PUNET E KRYERA SHERBIMET PUBLIKE ,INVESTIMET ETJ

### VITI 2023

1. Rikonstruksion rruga qendra e fshatit – varreza fshati PESHTAN
2. Mirembajtje cezma publike fshati Peshtan
3. Rikonstruksion ruge fshati MEZHGORAN
4. Sistemim I ujrave te larta unaza veriore fshati Dragot
5. Shtrim me beton rruga varreza- cezma publike
6. Shtrim me beton rruge te brendshem BECISHT
7. Rikonstruksion rruga e fshatit Koder
8. Mirembajtje ujsjellesi fshti Koder
9. Sistemim I qendres fshatit Koder.
10. Rikonstruksion e shtrim me beton rrugert e brendeshme Hormove
11. Rikonstruksion rruge Subash – Hormove
12. Rikonstruksion pasarella e fshatit Hormove
13. Rikonstruksion I rrugëve te brendeshme fshati VELIQOT
14. Rikonstruksion I rrugëve te brendeshme fshati BENCE
15. Rikonstruksion I rrugëve te brendshme fshati Dukaj
16. Rikonstruksio I rrugëve te brendeshme fshatrat e Njesise Lopes
17. Rikonstruksion I rrugëve te brendeshme fshatrat e njesise Kurvelesh
18. Mirembajtje e ujsjellesit fshati Gusmar
19. Cbllokime te herepashershme te rruges Tepelene – LEKDUSH ,Gusmar – Kuc
20. Rikonstruksion lapidaret SALARI, Veliqot, Memoriali I Kodres, LAPIDARI mezhgoranit dhe shkalla e zeze
21. Mirembajtja e institucioneve shkollore
22. Rrethim I jashtem I shkolles Mezhgoran,Dragot,Koder,Hormove,Progonat,Dukaj
23. Vendorsje kaldaja te reja ne shkollen 7 Marsi dhe KOPSHTIN E FEMIJEVE “Murat Kociu “
24. Sistemi dhe shtrim me betom I rrugëve te lagjes Majkosh
25. Sistemim e reabilitim I rrugëve te lagjes Corodol
26. Sistemime shtrim me beton I blloqeve te banimit e rrugëve te brendeshme ne qytet me je siperfaqe 3,200 m2
27. Ndricim public I rruges Deshmoret e Lirise “ rruga Gjon Dervishi ,Unaza Veriore,Rruga Kisha ISH Prokuroria.
28. Shtrirja e sherbimit te pastrimit pothuajse ne te gjithë teritorin e Bashkise
29. Vendoja e 160 konteniervë
30. Reabilitim e sistemi fusha e mebetjeve Majkosh
31. Rikonstrksion I kuz ne qytet
32. Vendorsja e staloave te rinj rreth 50 cop dhe koshave te vegjel ne rruget kryesore rreth 30 cop
33. Sinjalistika horizontale e vertikale ne te gjithë rruget e qytetit.
34. Paisja me kamera e te gjithë institucioneve

35. Aktivitete të larmishme sociale dhe kulturore që kulmoi me festimet e 80 vjetorit të qytetit.

#### Buxheti SOCIAL

- Ndihma të menjehershme financiare për raste të renda e fatkeqesi që kanë përfituar rreth 25 familje me një fond rreth 3,500,000 lekë
- Ndihme ekonomike nga Buxheti I Bashkisë nr I përfituesve rreth 70 familje me një vlerë 2,500,000 lekë
- Bonusi I qirave përfitues rreth 50 familje me një fond 4,200,000 lekë
- Rimbursimi I një pjese të shpenzimeve të transportit për nxënësit e Njësise Administrative Lopes që frekuentojnë shkollën në qytet me një vlerë rreth 450,000 lekë

Shuma 29,000,000 lekë

#### INVESTIMET ME BUXHETIN E PAVARUR

- Rikonstruksion I rrugës së fshatit Mamaj me një vlerë 9,200,000 lekë
- Sistemim asfaltim I rrugës Unaza Veriore dhe rrugës Taip Xhihani me një vlerë 6,500,000 lekë
- Sistemim asfaltim unaza veriore Dragot

Shuma; 15,700,000 lekë

#### Investimet me buxhetin e Shtetit

- Rikonstruksion Ujësjetisi i Progonat – Dhemblan
- Rikonstruksion I Ujësjetesit fshati Nivice – Rexhin, Peshtan -Mezhgoran
- Rikonstruksion ujësjetesi fshati SALARI
- Furnizim . e vendosje matësia në pallatet me një kollonë në qytet
- Rikonstruksion I shkolles 9 Vjeçare ‘Avni Rustemi ‘ ku bashkia është bashkefinancuese në masën 15 % të investimit.

Shuma e investimeve 500,000,000 lekë

#### INVESTIMET E BUXHETIT TË SHITIT KË PËRFITUESË SHITË BASHKIA TËPELENË

- Eficienca e energjisë në pallatet në qytet  
85,000,000 lekë
- Rrjetëzimi I Kalasë

500,000,000 le



## INVESIMET E KRYERA NE VITITN 2023

❖ Buxheti i Bashkise ; Shuma 4,124,000 leke

1. Rikonstruksion fasada unaza veriore ne Shumen **2,000,000 leke**
2. Blerje paisje kompjuterike ne Shumen ..... **1,254,000 leke**
3. F.v kaladaj kopeshti I femijeve “Murat Kociu”..... **870,000 leke**

**Buxheti I Shtetit ; Shuma 70,269,000 leke**

1. F.v matesa ne kollone ne shuymen .....14,693,000 leke
2. Supervizim objekti.F.v matesa ..... 100,000 leke
3. Rikonstruksion shkolla Avni Rustemi.....55,476,000 leke

### TOTALI I INVESTIMEVE 74,393,000 LEKE

❖ Situata financiare ne lidhje me detyrimet e prapambetura.

| N.R      | Emërtimi                | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve faktike për NJQV-në | Stoku/Shpenzi meve totale faktike të NJQV-së |
|----------|-------------------------|----------------|------------------------------------------|----------------------------------------------|
| <b>I</b> | <b>Borxhe (a+b)</b>     | <b>0</b>       |                                          |                                              |
| <b>a</b> | <b>Hua afatgjatë</b>    | <b>0</b>       |                                          |                                              |
| a,1      | Principali              |                |                                          |                                              |
| a,2      | Interesi                |                |                                          |                                              |
| <b>b</b> | <b>Hua afatshkurtër</b> | <b>0</b>       |                                          |                                              |
| b,1      | Hua                     |                |                                          |                                              |
| b,2      | Overdrafte              |                |                                          |                                              |

|                           |                                 |                   |                    |               |
|---------------------------|---------------------------------|-------------------|--------------------|---------------|
| b,3                       | Kredi të furnitorëve            |                   |                    |               |
| <b>II</b>                 | <b>Detyrimet e prapambetura</b> | <b>33,874,193</b> |                    | <b>12.41%</b> |
| <i>Llogaria ekonomike</i> | <b>Emertimi</b>                 |                   |                    |               |
| 4864100                   | Vendime Gjyqesore               | 122,999           |                    |               |
| 4864200                   | Det.Prap..Sherbime              | 3,518,978         |                    |               |
| 4864201                   | D.P.Energji elektrike           | 6,820,872         |                    |               |
| 4864300                   | Det.Prap.Mirembajtje            | 3,317,713         |                    |               |
| 4864400                   | Det.Prap.Investime              | 5,528,329         |                    |               |
| 4864500                   | Det.Prap.Rimbursim TVSH         | 0                 |                    |               |
| 4864600                   | Mallra                          | 14,565,302        |                    |               |
| 4864900                   | Det.Prap.Te Tjera               | 0                 |                    |               |
| 4864601                   | Det.Prap. Sig Shoqerore         | 0                 |                    |               |
| 4864602                   | Det.Prap.Sig.Shendetsore        | 0                 |                    |               |
| 4864603                   | Det.Prap.Ardhura Personale      | 0                 |                    |               |
| 4864604                   | Det.Prap.Tatime te tjera        | 0                 |                    |               |
| 4864901                   | Paga                            | 0                 |                    |               |
| 4864902                   | Shpronsime                      | 0                 |                    |               |
| 4864903                   | Trans.individ                   | 0                 |                    |               |
| 4864904                   | Trans.Subjektet                 | 0                 |                    |               |
| <b>III</b>                | <b>Totali (I+II)</b>            | <b>33,874,193</b> | <b>273,053,170</b> | <b>12.41%</b> |

Ne bazet te tregueseve te mesiperme Bashkia Tepelene konsiderohet ne situate normale te gjendjes financiare

|                                          |
|------------------------------------------|
| Situata Normale e gjendjes<br>fiannciare |
|------------------------------------------|

❖ **Cilat jane disa nga problematikat kryesore qe jane vrejtur gjate ketij vitit ushtrimor per te permiresuar ne te ardhmen .**

- Nje ndryshim rrenjesor ne punen e mbledhjes se te ardhurave si nga Sektori e Tatim Taksave si dhe agjentet e tjere tatimor ku nje rol te rendesishem ze Drejtoria e Bujqesise, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimi e Kontrollit mbi Territorin e Policia Bashkiake
- Planifikim I sakt dhe zgjerimi I bazes se tatim paguesve si ne qytet dhe ne njesite administrative.
- Planifikim I sakt e I argumentuar I kerkesave per shpenzime nga njesite shpenzuese .
- Pune me e kujdesshme e me pergjegjesi me te larte te Drejtorise Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ne dokumentimin ne kohe dhe kryerjen e pagesave vetem kur ato te jene te shoqeruara me dokumentacionin e plot justifikues dhe te jene te programuara ne buxhetet afatmesme e vjetore.
- Permiresimi ne vazhdimesi I rregullores se brendeshme te institucionit ku te percaktohen qarte detyrat e gjithesecilit dhe mbi kete baze te dale dhe pergjegjesia.
- Auditimi I performances dhe funksionimi I sistemeve te kontrollit te brendshem mbete nje nga drejtimet kryesore.
- Zbatimi I Rekomandimeve te KLSH eshte nje prioritet kryesor

N/Zbatues

Spiro Kora



## PASQYRAT FINANCIARE VITI 2023

### ( Komente e Analiza )

- Lista emërore e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ku përfshihen funksioni, niveli i pagës për pozicion, kategoria statusi i punonjësit, dhe kontrata individuale e punonjësve, si dhe urdhërat e emerimit të punonjësve. etj.
- Lista emërore dhe evidenca mbi emërimin e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe kontrata individuale e punonjësve, etj.
- Bilancet kontabël dhe pasqyrat financiare për vitin 2023 dërguar dhe rakorduar me Degën e Thesarit.
- Analitikët për vitin 2023 të llogarive;
  - 468 Debitor te ndryshem
  - 4342 Operacione me shtetin( te drejta )
  - 481 Shpenzime per tu shperndare
  - 486 Shpenzime te periudhave te ardhshme,
  - 202 Studime dhe Kerkime
  - 210 Toka, T,roje, Terene
  - 211 Pyje, Plantacione
  - 212 Ndertesa e Konstruksione
  - 213 Rruge, rrjete, vepra ujore
  - 214 Instalime teknike, makineri e paisje
  - 215 Mjete Transporti
  - 218 Inventari ekonomik
  - 24 AAGJ te demtuara
  - 230 SHp.AAGJIM ne process
  - 231 Shp.AAGJIM ne proces
  - 401-408 Furnitore e llogari te lidhura me to
  - 466 Kreditore per mjete ne ruajtje
  - 467 Kreditore te ndryshem
  - 475 ardhura per tu rregjistruar
- Dokumentet origjinale justifikuese dhe argumentuese të regjistruara për kryerjen e veprimeve financiare kontabile (mandat arkëtime, mandat pagesa, kontrata, fatura, situacione, urdhër shpenzime, fletë hyrje, fletë dalje, etj).
- Situacionet e shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2023 janë hartuar dhe depozituar më datën 06.02.2024 në Degën e Thesarit, me nr.prot 238

### **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare**

Në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",

Formati 1 – Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 – Pasqyra e Performancës Financiare

Formati 3 – Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Floë*)  
 Formati 4 – Pasqyra e ndryshimeve në Aktivët Neto/ Fondet Neto  
 Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese  
 Formati 6 – Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit  
 Formati 7/a – Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike  
 Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto  
 Format 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

**Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.**  
 Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale.

**Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.**

- a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:  
 Aktivët ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
- b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve

### 1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët = 2,736,240,245 lekë

|                                   | Viti 2023     |
|-----------------------------------|---------------|
| AKTIVET                           | 2,736,240,245 |
| PASIVET(DETYRIMET)                | 2,736,240,245 |
| <b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b> | <b>0</b>      |

Burimi: Bashkia

#### 1.1 Aktivët afatshkurtra

Aktivët afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **220,409,497 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 19,652,145 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 25,604,836 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 141,278,323 lekë dhe “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 33,874,193 lekë.

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive       | Viti 2023         | Viti i 2022       | Diferenca 2023-2022 |
|--------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| 531                | Mjete monetare në arkë     | -                 | -                 | -                   |
| 512                | Mjete monetare në bankë    | -                 | -                 | -                   |
| 520                | Disponibilitete në thesar  | 19,652,145        | 14,411,297        | 5,240,248           |
| 50                 | Letra me vlerë             | -                 | -                 | -                   |
| 532                | Vlera të tjera             | -                 | -                 | -                   |
| 54                 | Akredeitiva dhe paradhënie | -                 | -                 | -                   |
| 59                 | Provizione zhvlerësimi     | -                 | -                 | -                   |
|                    | <b>TOTALI</b>              | <b>19,652,145</b> | <b>14,411,297</b> | <b>5,240,248</b>    |

Burimi: Bashkia

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën **19,652,145 lekë**, përbëhet nga:



- Llog 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në shumën 16,426,025 lekë; dhe
  - Llog 85 "Rezultati i veprimtrisë ushtrimore" në shumën 3,226,120 lekë;
- Llogaria 520 "Disponibiliteti në thesar" është paraqitur saktë në bilanc.

**- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:**

| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive                       | Viti 2023         | Viti 2022         | Diferenca 2023-2022 |
|--------------------|--------------------------------------------|-------------------|-------------------|---------------------|
| 31                 | Materiale                                  | 7,435,068         | 1,411,158         | 6,023,910           |
| 32                 | Objekte inventari Inventar i imët          | 18,169,768        | 17,204,608        | 965,160             |
| 33                 | Prodhime, punime e shërbime ne proces      |                   |                   |                     |
| 34                 | Produkte                                   |                   |                   |                     |
| 35                 | Mallra                                     |                   |                   |                     |
| 36                 | Gjë e gjalle ne rritje e majmeri           |                   |                   |                     |
| 37                 | Gjendje te pambritura ose pranë të treteve |                   |                   |                     |
| 38                 | Diferenca nga çmimet e magazinimit         |                   |                   |                     |
| 39                 | Provizione për zhvlerësim te inventarit(-) |                   |                   |                     |
|                    | <b>Totali</b>                              | <b>25,604,836</b> | <b>18,615,766</b> | <b>6,989,070</b>    |

Burimi: Bashkia

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën **25,604,836 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 "Materiale" për shumën 7,435,068 lekë;
- Llogaria kontabel 32 "Objekte inventari" për shumën 18,169,768 lekë;
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 6,989,070 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit" në shumën 6,989,070 lekë.
- **Llogaria 312 "Materiale"** ka vlerën 7,435,068 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Lëvizjet e llogarisë           | Vlera në lekë    |
|--------------------------------|------------------|
| Gjendje në 01.01.2022          | 1,411,158        |
| Hyrjet në magazinë gjatë vitit | 52,546,961       |
| Dalje nga magazina gjatë vitit | 46,523,051       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>   | <b>7,435,068</b> |

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 327 "Objekte inventari"** ka vlerën 18,169,768 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Lëvizjet e llogarisë         | Vlera në lekë     |
|------------------------------|-------------------|
| Gjendja në 01.01.2023        | 17,204,608        |
| Hyrje gjatë vitit 2023       | 965,16            |
| Dalje gjatë vitit 2022       | 0                 |
| <b>Gjendja në 31.12.2022</b> | <b>18,169,768</b> |

Burimi: Bashkia

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhërin e Inventarizimit Nr. 144, datë 26.10.2023 për "Kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qendrueshme, inventarit të imet e materialeve" ku është përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve.



Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

| Llogaritë kontabël | Emërtimi i llogarive                                | Viti 2023          | Viti 2022          | Diferenca 2022-2021 |
|--------------------|-----------------------------------------------------|--------------------|--------------------|---------------------|
|                    | <b>Llogari të arkëtueshme</b>                       |                    |                    |                     |
| 411                | Klientë e llogari të ngjashme                       |                    |                    |                     |
| 423,429            | Personeli, paradhënie, deficite e gjoba             | 1,254,774          | 1,254,774          | 0                   |
| 431                | Tatime e taksa                                      | -                  | -                  |                     |
| 432                | Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal | -                  | -                  |                     |
| 433                | Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti       | -                  | -                  |                     |
| 435                | Sigurime Shoqërore                                  | -                  | -                  |                     |
| 436                | Sigurime Shëndetësore                               | -                  | -                  |                     |
| 437,438            | Organizma të tjerë shoqërore                        | -                  | -                  |                     |
| 44                 | Institucione të tjera publike                       | -                  | -                  |                     |
| 466                | Kreditorë për mjete në ruajtje                      | -                  | -                  |                     |
| 468                | Debitorë të ndryshëm                                | -                  | -                  |                     |
| 4342               | Te tjera operacione me shtetin(debitor)             | 153,584,876        | 150,593,337        | 2,991,539           |
| 45                 | Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit   | 27,529,213         | 27,147,963         | 381,250             |
| 49                 | Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)             | -                  | -                  |                     |
|                    | <b>Totali</b>                                       | <b>-41,090,540</b> | <b>-41,090,540</b> | <b>0</b>            |
|                    | <b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>                 | <b>141,278,323</b> | <b>137,905,534</b> | <b>3,372,789</b>    |
| 409                | Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore       | -                  | -                  |                     |
| 473                | Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin     | -                  | -                  |                     |
| 477                | Diferenca konvertimi aktive                         | -                  | -                  |                     |
| 481                | Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime       | -                  | -                  |                     |
| 486                | Shpenzime të periudhave të ardhshme                 | 33,874,193         | 26,173,384         | 7,700,809           |
|                    | <b>Totali</b>                                       | <b>33,874,193</b>  | <b>26,173,384</b>  | <b>7,709,809</b>    |

Burimi: Bashkia

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2023 është në vlerën 153,584,876 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepicën e vitit 2022 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 2,991,539 lekë.

| Lëvizjet e llogarisë                        | Vlera në lekë      |
|---------------------------------------------|--------------------|
| Gjendja në 01.01.2023                       | 150,593,337        |
| Shtesa gjatë vitit 2023 debitorët e taksave | 5,554,226          |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K)               | 2,562,687          |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>                | <b>153,584,876</b> |

Burimi: Bashkia

Gjatë evidentimit të llogarive analitike janë evidentuar në llogaritë analitike për vitin 2023 debitorët për taksat dhe tarifat vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë, janë evidentuar detyrimet për vitin 2023, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

| Debitorë Bashkia dhe NJA           | Gjendja 31.12.2023 | Gjendja 31.12.2022 |
|------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Debitorë Gjoba IVMT                | 2,290,000          | 2,290,000          |
| Debitorë KLSH                      | 84,992,244         | 84,992,244         |
| Debitorë Legalizim                 | 2,097,557          | 2,078,936          |
| Debitorë Biznesi (zyra e tatimeve) | 22,226,565         | 20,381,318         |

|                                      |                    |                    |
|--------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Debitorë Ujesjellesi Agjent tatimor) | 16,443,652         | 15,315,981         |
| Debitorë Kontrata qeraje             | 816,212            | 816,212            |
| Debitorë në pamundësi arkëtimi       | 24,718,646         | 24,718,646         |
| <b>Totali</b>                        | <b>153,584,876</b> | <b>150,593,337</b> |

Burimi: Bashkia

Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku citohet:

“Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:

☐ Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.

☐ Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.

Të drejtat. Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohej (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).

Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).

Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmblendhur është si më poshtë:

a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:

☐ **Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);**

☐ Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);

☐ **Kreditohet klasa 7 me analiza;**

☐ Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).

b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:

☐ Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;

☐ Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.

c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

☐ Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);

☐ Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;

☐ Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)”

Pra është vlerësuar Llogaria 468 “Debitorë të ndryshën” dhe Llogaria e 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatime” duke e njohur të ardhurën për vitin 2022 në vlerën 150,593,337 lekë dhe për vitin 2023 në vlerën 153,584,876 lekë.

- **Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 27,529,213 lekë kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 27,529,213 lekë. Vlera prej 27,529,213 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

| Lëvizjet e llogarisë         | Vlera në lekë |
|------------------------------|---------------|
| Gjendja në 01.01.2023        | 27,147,963    |
| Shtesa gjatë vitit 2023(D)   | 27,529,213    |
| Pakësime gjatë vitit 2023(K) | 27,147,963    |



|                              |                   |
|------------------------------|-------------------|
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b> | <b>27,529,213</b> |
|------------------------------|-------------------|

Burimi: Bashkia

Në mënyrë analitike paraqitet:

|               |                                       |                   |
|---------------|---------------------------------------|-------------------|
| 401-408       | Furnitore e llogari te lidhura me to  | 2,704,387         |
| 42            | Detyrime ndaj personelit              | 12,398,209        |
| 431           | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 1,736,624         |
| 435           | Sigurime Shoqerore                    | 3,654,183         |
| 436           | Sigurime Shendetstore                 | 515,396           |
| 437,438,      | Organizma te tjere shteterore         | 0                 |
| 467           | Kreditore te ndryshem                 | 6,520,414         |
| <b>TOTALI</b> |                                       | <b>27,529,213</b> |

Burimi: Bashkia

- Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 26,173,384 lekë.

| Lëvizjet e llogarisë          | Vlera në lekë     |
|-------------------------------|-------------------|
| Gjendja në 01.01.2023         | <b>26,173,384</b> |
| Shtesa gjatë vitit 2023(D)    | 22,192,112        |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | 14,491,303        |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>  | <b>33,874,193</b> |

Burimi: Bashkia

Vlera e kësaj llogarie në shumën **33,874,193 lekë**, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2023 ka patur një shtim të kësaj llogarie, pasi janë pa likujduar një pjesë e këtyrë detyrimeve.

| Emërtimi i llogarive    | Vlera             |
|-------------------------|-------------------|
| Shenzime gjyqësore      | 122,999           |
| Shpenzime operative     | 28,767,965        |
| Shpenzime për investime | 4,983,229         |
| <b>Totali</b>           | <b>33,874,193</b> |

Burimi: Bashkia

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara".

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## 1.2 Aktivet afatgjata

### Mbi Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)



Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale” në vlerën prej **352,003 lekë** përbëhen nga:

- Llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 352,003 lekë.

Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është 352,003 lekë.

Diferenca 352,003 lekë është vlera e projektit të rehabilitimit të fushës së mbetjeve, dhuruar nga Ministria e Mjedisit.

| Lëvizjet e llogarisë           | Vlera në lekë  |
|--------------------------------|----------------|
| Gjendja në 01.01.2023          | 352,003        |
| Shtesa gjatë vitit 20223(D)    | 0              |
| Pakësime gjatë vitit 2023(K)   | 0              |
| <b>Gjendja në 31.12.2023D)</b> | <b>352,003</b> |

Burimi: Bashkia

### Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 20223rezulton në vlerën neto 352,003 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 “Studime e kërkime”.

Analitikisht llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet si më poshtë;

| Nr | Emërtimi                                                  | Njësia | Sasia | VL.Kontabël    | Amortizimi |
|----|-----------------------------------------------------------|--------|-------|----------------|------------|
| 1  | Studim Projektim Rehabilitimi i fushës së mbetjeve Makosh | Copë   | 1     | 352,003        | 0          |
|    | <b>Totali</b>                                             |        |       | <b>352,003</b> | <b>0</b>   |

Burimi: Bashkia

### Mbi Aktive afatgjata financiare

#### Testet substanciales

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2023 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 0 lekë Ky seksion i bilancit kontabël për vitet 2022 dhe 2023 është paraqitur në vlerën 0 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

| Nr. Reshti | Referenca e Llogarive | EMERTIMI                             | Ushtrimi i Mbyllur | Ushtrimi Paraardhës |
|------------|-----------------------|--------------------------------------|--------------------|---------------------|
| 59         | 25-26                 | <b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b> | <b>0</b>           | <b>0</b>            |
| 60         | 25                    | Huadhenie e Nenhuadhenie             | 0                  | 0                   |
| 61         | 26                    | Pjesmarrje në kapitalin e vet        | 0                  | 0                   |

Burimi: Bashkia

### Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

- Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten në shumën 2,236,319,642 lekë ( me vlerë neto). Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,236,706,994 lekë (me vlerë neto), me një pakesim të AAM-ve në shumën 387,352 lekë, si dhe të pakësimeve të AAM-ve

për 63,690,494 lekë që kanë ardhur kryesisht si rezultat nga llogaritja e amortizimit per AQT në Bashki.

Duke analizuar veprimet e shitesave dhe pakësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës si në tabelën më poshtë,

| Nr. | Llogaria | Emërtimi                                     | Gjendja me 31.12.2022 | SHTESA      | PAKSIME    | Gjendja me 31.12.2023 |
|-----|----------|----------------------------------------------|-----------------------|-------------|------------|-----------------------|
| 1   | 210      | Toka,troje, Terene                           | 269,805,883           | 30,769,702  | 0          | 300,575,585           |
| 2   | 211      | Pyje,Kullota Plantacione                     | 834,513,598           | 101,064,034 | 0          | 935,577,632           |
| 3   | 212      | Ndertime e Konstruksione                     | 436,066,935           | 2,467,646   | 0          | 438,534,581           |
| 4   | 213      | Rruge,rrjete,vepra ujore                     | 1,054,594,327         | 60,917,040  | 34,040,000 | 1,081,471,367         |
| 5   | 214      | Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune | 11,738,947            | 870,000     | 0          | 12,608,947            |
| 6   | 215      | Mjete transporti                             | 22,605,689            | 0           | 0          | 22,605,689            |
| 7   | 218      | Inventar ekonomik                            | 37,235,746            | 1,254,720   | 0          | 38,490,466            |
|     |          | TOTALI                                       | 2,666,913,128         | 197,343,142 | 34,040,000 | 2,830,216,270         |

Burimi: Bashkia

- **Llogaria. 210 "Toka, Troje, Terrene"** është në vlerën 300,575,585 me 31.12.2023, me një ndryshim në shtesë për 30,769,702 si rrjedhojë e rregjistrimit të pasurive në ASHK.
- **Llogaria 211 "Pyje, Plantacione"** paraqitet më 31.12.2022 (me kosto historike) 935,577,632 lekë me një shtesë prej 101,064,034 lekë, ardhur nga rregjistrimi i pasurive në ASHK.
- **Llogaria e aktivitetit 212 "Ndërtesa dhe konstruksione"** e cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë, në fund të vitit 2022 rezulton me një kosto historike 436,066,935 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një kosto historike 438,534,581 lekë, me një shtesë prej 2,467,646 lekë nga investimet e kryera dhe të përfunduara gjatë vitit 2023.
- Lista me kosto historike e ndërtesave paraqitet në aneks;
- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2023 në shumën 22,605,689 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2022 në vlerën 22,605,689 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2023 nuk ka patur shtesa në Llogarinë 215 "Mjete transporti".

| Lëvizjet e llogarisë          | Vlera në lekë |
|-------------------------------|---------------|
| Gjendja në 01.01.2023         | 22,605,689    |
| Shtesa gjatë vitit 2023 (D)   | 0             |
| Pakësime gjatë vitit 2023 (K) | 0             |
| Gjendja në 31.12.2023 (D)     | 22,605,689    |

Burimi: Bashkia



**Tabela nr. 2- Llogaria analitike 215**

| Nr. | Emërtimi                     | Çmimi     | Sipas të dhënave kontabël |            |
|-----|------------------------------|-----------|---------------------------|------------|
|     |                              |           | Sasia                     | Vlera      |
| I   | Bashkia                      |           |                           | X          |
| 1   | Autoveturë                   |           | 1                         |            |
| 2   | Mjet eskavator               | 2,500,000 |                           | 2,500,000  |
| 3   | Automjet tip Benz            | 3,132,000 | 1                         | 3,132,000  |
| 4   | Automjet Mitsubishi          | 1,830,000 | 1                         | 1,830,000  |
| 5   | Automjet Benz                | 1,998,200 |                           | 1,998,200  |
| 6   | Automjet Zjarrfikes          | 1,998,000 | 1                         | 1,998,200  |
| 7   | Automjet Zjarrfikes          | 3,404,309 | 1                         | 3,404,309  |
| 8   | Automjet Zjarrfikes          | 959,880   | 1                         | 959,880    |
| 9   | Makine teknologjike pastrimi | 1,500,000 | 1                         | 1,500,000  |
| 10  | Makine teknologjike pastrimi | 1,000,000 | 1                         | 1,000,000  |
| 11  | Mjet sherbimi Kamion         | 120,000   | 1                         | 120,000    |
| 12  | Mjet teknologjik pastrimi    | 910,800   | 1                         | 910,800    |
|     | TOTALI                       | 4,252,500 | 1                         | 4,252,500  |
|     |                              |           |                           | 22,605,689 |

Burimi: Bashkia

- **Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik"** përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njesitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 12,700,796 lekë (vlere neto). Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 "Inventari ekonomik" është pakesuar për vlerën 1,920,479 lekë.

| Levizjet Llog. 218 "Inventar ekonomik" për vitin 2022, vlera |            |
|--------------------------------------------------------------|------------|
| Çelje me 01.01.2023                                          | 14,621,275 |
| Blerje me pagesë (D)                                         | 1,254,720  |
| Blerje pa pagese (D)                                         | 0          |
| Dalje nxjerrje jashtë përdorimit (K)                         | 0          |
| Amortizimi i vitit i akumuluar 2023                          | 3,175,199  |
| Gjendja me 31.12.2023 (D) Teprica Neto                       | 12,700,796 |

Burimi: Bashkia

Llogaria 218 "Inventar ekonomik" amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 3,175,199 lekë duke përdorur normë amortizimi 20%, në përputhje me UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet " Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara".



Pasqyra statistikore nr. 7.b "Aktivet afatgjata me vlerë neto"

| Nr.<br>Reference<br>Llogarije | EMERTIMI                                     | Teprica<br>Neto      | Shtesat gjate vitit |                   | Paksimet gjate vitit |           | Teprica ne Fund      |                        |                      |
|-------------------------------|----------------------------------------------|----------------------|---------------------|-------------------|----------------------|-----------|----------------------|------------------------|----------------------|
|                               |                                              |                      | Kosto<br>Historike  | Amortizim         | Kosto<br>Historike   | Amortizim | Kosto<br>Historike   | Amortizim<br>Akumuluar | Teprica<br>Neto      |
| b                             | c                                            | 3                    | 4                   | 5                 | 6                    | 7         | 8                    | 9                      | 10                   |
| 20                            | <b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>                  | <b>352,003</b>       | <b>0</b>            | <b>0</b>          |                      |           | <b>352,003</b>       | <b>0</b>               | <b>352,003</b>       |
| 201                           | Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave  | 0                    |                     |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
| 202                           | Studime dhe kerkime                          | 352003               | 0                   |                   |                      |           | 352,003              | 0                      | 352,003              |
| 203                           | Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme | 0                    |                     |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
| 21- 28                        | <b>II. AAGJ/ MATERIALE</b>                   | <b>2,236,706,994</b> | <b>197,343,142</b>  | <b>63,690,494</b> |                      |           | <b>2,829,864,267</b> | <b>493,544,625</b>     | <b>2,336,319,642</b> |
| 210                           | Toka,troje,Terene                            | 269,805,883          | 30,769,702          | 0                 |                      |           | 300,575,585          | 0                      | 300,575,585          |
| 211                           | Pyje,Kullota Plantacione                     | 834,513,598          | 101,064,034         | 0                 |                      |           | 935,577,632          | 0                      | 935,577,632          |
| 212                           | Ndertime e Konstruksione                     | 312,012,841          | 2,467,646           | 18,474,437        |                      |           | 438,534,581          | 142,528,531            | 296,006,050          |
| 213                           | Rruge,rrjete,vepra ujore                     | 793,031,633          | 60,917,040          | 39,651,582        |                      |           | 1,081,471,367        | 301,214,276            | 780,257,091          |
| 214                           | Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune | 6,254,800            | 870,000             | 1,095,883         |                      |           | 12,608,947           | 6,580,030              | 6,028,917            |
| 215                           | Mjete transporti                             | 6,466,964            | 0                   | 1,293,393         |                      |           | 22,605,689           | 17,432,118             | 5,173,571            |
| 216                           | Rezerva shtetore                             | 0                    | 0                   |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
| 217                           | Kafshe pune e prodhimi                       | 0                    | 0                   |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
| 218                           | Inventar ekonomik                            | 14,621,275           | 1,254,720           | 3,175,199         |                      |           | 38,490,466           | 25,789,670             | 12,700,796           |
| 24                            | Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara     | 0                    | 0                   |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
| 28                            | Caktime                                      | 0                    | 0                   |                   |                      |           | 0                    | 0                      |                      |
|                               | <b>TOTALI (I+II)</b>                         | <b>2,237,058,997</b> | <b>197,343,142</b>  | <b>63,690,494</b> |                      |           | <b>2,830,216,270</b> | <b>493,544,625</b>     | <b>2,336,671,645</b> |

Burimi: Bashkia

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

## Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2023, paraqiten në vlerën 179,159,103 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 179,159,103 lekë.

| Nr. | Emërtimi i investimit        | Vlera              |
|-----|------------------------------|--------------------|
| 1   | Aktive Afatgjata jomateriale | X                  |
| 2   | Aktive Afatgjata materiale   | 179,159,103        |
| 3   | <b>Totali</b>                | <b>179,159,103</b> |

Burimi: Bashkia

Për investimet e kryera gjatë vitit 2023, është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 21 "Aktive afatgjata". Në mënyra analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në aneks.

### 1.3 PASIVET (DETYRIMET)

#### **Pasivet Afatshkurtra**

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

| Llogaritë |                                       | Viti 2023          | Viti 2022          | Diferenca/ndryshimi |
|-----------|---------------------------------------|--------------------|--------------------|---------------------|
| 401-408   | Furnitore e llogari te lidhura me to  | 4,973,015          | 5,544,358          | -571,343            |
| 42        | Detyrime ndaj personelit              | 12,398,209         | 9,224,232          | 3,173,977           |
| 431       | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 1,736,624          | 501,183            | 1,235,441           |
| 435       | Sigurime Shoqerore                    | 3,654,183          | 2,570,834          | 1,083,349           |
| 436       | Sigurime Shendetesore                 | 515,396            | 351,714            | 163,682             |
| 437,438,  | Organizma te tjere shteterore         | X                  | X                  | X                   |
| 466       | Kreditore per mjete ne ruajtje        | 16,426,025         | 12,812,451         | 3,613,574           |
| 467       | Kreditore te ndryshem                 | 38,125,979         | 28,229,661         | 9,896,318           |
| 4341      | Operacione me shtetin( detyrime       | 113,749,110        | 111,655,654        | 2,093,456           |
|           | <b>Gjendja më fund të periudhës</b>   | <b>191,578,541</b> | <b>170,890,087</b> | <b>20,688,454</b>   |

Burimi: Bashkia

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në fund të vitit 2023 është në vlerën 4,973,015 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia më 31.12.2023. Lëvizja e llogarise 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

| <b>Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"</b> |                  |
|-------------------------------------------------------------|------------------|
| Celje e vitit 2023                                          | <b>5,554,358</b> |



|                                  |                  |
|----------------------------------|------------------|
| Shtesa (K)                       | 137,713,583      |
| Pakësime (D)                     | 138,284,926      |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b> | <b>4,973,015</b> |

Burimi: Bashkia

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën **4,973,015** lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë, paraqitet në vlerën 12,398,209 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.
- **Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa"**, paraqitet në vlerën 1,736,624 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për detyrimet e muajit Dhjetor 2023 të cilat do të paguhen në muajin janar të vitit pasardhës.
- **Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për muajin Dhjetor 2023 4,169,579 lekë.
- **Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje"**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 16,426,025 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 16,426,025 lekë.

| <b>Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"</b> |                   |
|---------------------------------------------------|-------------------|
| Celje e vitit 2023                                | <b>12,812,451</b> |
| Shtesa                                            | 3,671,174         |
| Pakësime                                          | 57,600            |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>                      | <b>16,426,025</b> |

Burimi: Bashkia

Kjo shumë është e njëjtë me terpicën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520. Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nënlllogarive përkatëse jepet në aneks. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private. Në mënyrë analitike, garancitë të cilat janë të trashëguara dhe janë të objekteve të përfunduar, për të cilën është mbajtur kjo garanci dhe është marrë në dorëzim, sipas vitit përkatës, paraqiten si në aneks. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje" duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"**, paraqiten faturat e palikuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2023 paraqiten në shumën 38,125,979 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

| <b>Lëvizjet e llogarisë</b> |                   |
|-----------------------------|-------------------|
| Gjendja në 01.01.2023       | <b>28,229,661</b> |



|                               |                   |
|-------------------------------|-------------------|
| Shtesa gjatë vitit 2022 (d)   | 168,231,340       |
| Pakësime gjatë vitit 20223(k) | 158,335,022       |
| <b>Gjendja në 31.12.2021</b>  | <b>38,125,979</b> |

Burimi: Bashkia

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi vërejtur se nuk ka fatura të likujduara të pa rregjistruara në SIFQ për vitin 2023

- **Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit"**, paraqitet me teprice kreditore në vlerën **13,226,120** lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohe.

## 2. Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-**Të ardhurat dhe shpenzimet**, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë më datë 31.12.2023 janë të kuadruara me Degën e Thesarit, konkretisht:

### Rakordimi të ardhurave

| Emërtimi                           | Vlera sipas Pasqyrës së Performancës | Dokumentimi                       | Vlera              | Dif      |
|------------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------------|--------------------|----------|
| Të ardhurat e krijuara gjatë vitit | 46,602,469                           | Akt rakordimi me Degën e Thesarit | 46,602,469         | 0        |
| Granti nga buxheti                 | 313,018,387                          | Sipas çeljes së buxhetit nga MFE  | 313,018,387        | 0        |
| Financim i pritshëm nga buxheti    | 27,529,213                           | Sipas llogarisë 7206              | 27,529,213         | 0        |
| <b>Totali të ardhurave</b>         | <b>387,150,069</b>                   | <b>Totali të ardhura</b>          | <b>387,150,069</b> | <b>0</b> |

Burimi: Bashkia

### Rakordimi i Shpenzimeve

| Emërtimi      | Sipas Situacionit  | Detyrimet e vitit 2022 | Detyrime të vitit 2023 | Sipas Pasqyrës së Performancës |
|---------------|--------------------|------------------------|------------------------|--------------------------------|
| 600           | 154,698,759        | 9,555,443              | 12,398,209             | 157,532,525                    |
| 601           | 14,965,236         | 2,922,548              | 4,169,579              | 16,212,267                     |
| 602           | 95,521,615         | 14,669,972             | 10,981,839             | 91,833,482                     |
| 604           | 6,146,527          | 0                      | 0                      | 6,146,527                      |
| 606           | 119,188,218        | 0                      | 0                      | 119,188,218                    |
| 63            | 0                  | 0                      |                        | - 6,989,070                    |
| <b>Totali</b> | <b>390,511,355</b> | <b>27,147,963</b>      | <b>27,549,627</b>      | <b>383,923,949</b>             |

Burimi: Bashkia

-Diferenca në shumën 6,989,070 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej 6,989,070 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

#### **Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati**

|     | Emërtimi Burimi             | Pasqyra     | Situacioni  | Diferenca |
|-----|-----------------------------|-------------|-------------|-----------|
| I   | Totali të ardhura           | 387,150,069 | 387,150,069 | 0         |
| II  | Shpenzime                   | 383,923,949 | 383,923,949 | 0         |
| III | Rezultati i vitit ushtrimor | 3,226,120   | 3,226,120   | 0         |
| IV  | Rezultati i vitit ushtrimor | 3,226,120   | 3,226,120   | 0         |

Burimi: Bashkia

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **3,226,120 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

### **3. Pasqyra e flukseve monetare (F3)**

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023.

| Nr. Rubrike | PERMBAJTJA                                         | Periudha Raportuese | Periudha Paraardhëse |
|-------------|----------------------------------------------------|---------------------|----------------------|
| (b)         | (c)                                                | (1)                 | (2)                  |
| I           | Veprimtaritë e shfrytëzimit                        | 6,808,968           | 14,411,297           |
| II          | Veprimtaritë e investimeve                         | 0                   | 0                    |
| III         | Transferta e të tjera                              | -1,568,120          | -1,440,630           |
| IV          | Teperica në fillim të vitit ushtrimor              | 14,522,297          | 6,001,282            |
| V           | Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor | 19,652,145          | 14,411,297           |

Burimi: Bashkia

-Nga kontrollat e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023 e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **19,652,145 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Disponibilitet në Thesar" Llog 520" e cila paraqitet në shumën **19,652,145 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare".

### **Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)**

| Referenc | EMËRTIMI                  | Fonde bazë dhe Grante Kapitale | Fonde të tjera të veta | Rezultatet e Mbartura Teprioc/Deficit | Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/Deficit | GJITHËSIA Aktive/neto Fonde/ Neto |
|----------|---------------------------|--------------------------------|------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------------|
| 101      | IAKTIVET NETO/FONDET NETO | 2,263,274,894                  |                        |                                       |                                        | 2,263,274,89                      |



| II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/<br>FONDET NETO(1+2) |                                                   |               |  |  |             |               |
|-----------------------------------------------|---------------------------------------------------|---------------|--|--|-------------|---------------|
| I.NGA BURIME TE BRENDSHME                     |                                                   |               |  |  |             |               |
| 105,                                          | Nga grantet e brendshme kapitale(+)               |               |  |  | 269,384,249 | 281,386,813   |
| 1016,                                         | Nga Transfertat e brendshme te AAGJ,              |               |  |  | 137,082,867 | 149,082,867   |
| 1059                                          | Dhurata ne natyre, (+,-)                          |               |  |  | 108,259,590 | 108,259,590   |
| 12                                            | Nga Rezultatet e mbartura(+,-)                    | 6,001,282     |  |  | 101,290,215 | 101,290,215   |
| 85                                            | Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)             | 6,001,282     |  |  | -6,001,282  |               |
| 115                                           | Nga fondet e veta te investimeve (+,-)            |               |  |  | -2,775,162  | 3,226,120     |
| 1013                                          | Nga konsumi i AAGJ(-)                             |               |  |  |             |               |
| 1015                                          | Nga ndryshim gjendje ivent dhe sistemim te 218(-) |               |  |  | -63,690,494 | -63,690,494   |
| 1016                                          | Nga transftrat e brendeshme (dhurate ne natyre    |               |  |  |             |               |
| TOTALI                                        |                                                   | 2,263,274,891 |  |  | 132,301,382 | 132,301,382   |
|                                               |                                                   |               |  |  | 269,384,249 | 2,544,661,704 |

Burimi: Bashkia

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **2,544,661,704 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej 281,386,813 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej – 63,690,494 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.

-Vlera prej 3,226,120 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85 dhe llog. 12 paraqitet në shumën 0 lekë.

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **2,544,661,704 lekë**. kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

***Veprimet e mësipërme janë kryer sipas përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

- Ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10 dhe ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42.
- Ligji nr. 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10" ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" seksioni "Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 " Kreditorë për mjete në ruajtje".
- UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet " Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENE**

**RELACION**

**PER**

**ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE KONTRALLIT TE LARTE TE SHTETIT**

Mbështetur në, nenin 64, te Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, nenet 6,15,25, dhe 30 të ligjit 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” shkresës nr 422/8 prot, datë 28.09.2023 “Dërgohet Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” (për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022 ) në Bashkinë Tepelenë, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

Ju relatojme mbi masat e marra per zbatimin e rekomandimeve te KLSH

- Shkresa nr 2004/3 date 18.10.2023 ‘kthim pergjigje shkrese nr 422/8 prot date 28.09.2023 “dergohet raporti perfundimtar per auditimin e ushtruar ne Bashkine Tepelene (per periudhen 01.01.2022-31.12.2022 ) nga Kontrolli I Larte I Shtetit.
- Shkresa nr 2004/1 date 18.10.2023 “Deklarate ‘Per njohjen e Raportit te Auditimit “
- Urdher nr 137 date 18.10.2023 “Per zabtimin e detyrave te rekomanduara “
- Urdher nr 131 date 16.10.2023 “Per kryerjen e vizites fiskale ne te gjithë subjektet fizik/juridik qe ushtrojne veprimtarine ne Bashkine Tepelene .
- Plani I Veperimit I Drejtorise Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar me nr 988/15 date 23.10.2023 “Per zbatimin e detyrave te rekomanduara “
- Shkresa nr 988/19 Prot Dergohet per pagesen Takse ndikimi ne infrastruukture nga ndertimet e reja Z.Erjon Zeka
- Njoftim per pagesen e taksave e tarifave vendore te mbledhura me shkresen me nr 998/18 date 23.10.2023 Shoqerise Rajonale Ujesjelles – Kanalizime Gjirokaster.
- Shkresa nr 988/16 date 23.10.2023 Njoftim per pagesen e tarifes (Autorizim per tregetimin e karburanteve ) shoqeria Skenderi-G
- Shkresa nr 988/17 date 23.10.2023 Njoftim per pagesen e tarifes (Autorizim per tregetimin e karburanteve ) Shoqeria Braka sh.p.k
- Shkresa nr 988/20 Njoftim perfundimtar per pagesen e detyrimeve tatimore subjketi KOÇI sh.p.k
- Plani veprimit me Menaxhimin Financiar e Kontrollin Gjurma standarte e Auditimit per parandalimin e shlyerjen e detyrimeve financiare te prapambetura ( Borxhet )



- Njoftimet per likuidimin e detyrimeve tatimore te gjithë subjekteve debitorë
- Njoftim per pagesën e takses së ndikimit në infrastrukture per subjekte debitorë
- Urdhëra e bllokimit të llogarive bankare subjekteve debitorë.

## **MASA ADMINISTRATIVE ORGANIZATIVE**

- 1.1. Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.
- 1.2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

### ***Menjeherë e në vijimësi (Proces)***

- 2.1. Të merren masa nga Njësia e auditimit të brendshëm që planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike. Të merren masa për plotësim të strukturës në sektorin e auditimit të brendshëm.

### ***Njësia e auditimit, Burimet Njerëzore***

### ***Menjeherë e në vijimësi (Proces)***

- 3.1 Të merren masa nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar me bashkëpunimin e Drejtorive të tjera të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që programet e shpenzimeve Buxhetote gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara. Të sigurohet një përdorim të frytshëm i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat tona.

Të përgatitet materiali plotë, për gjendjen në fund të vitit ushtrimor, të faturave të palikujduara dhe të hartohet një grafik duke zbatuar radhën e pagesave. Të miratojë një program të detajuar mbi zvogëlimin gradual të detyrimeve kreditore, shoqëruar me reduktim të shpenzimeve të tjera në rritje të performancës në vjelje të të ardhurave lokale.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar***

***Në vijimësi  
(Proces)***

4.1. Sektori i Taksave dhe Tatimeve , të marrë masa, për nxjerje të njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët , duke ndjekur të gjithë rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 20,381,313 lekë. Të bashkërendojë punën me QKB , për moskalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë. Në regjistrat e debitorëve të evidentohen vlera të detyrimeve të paarkëtuara, statusi I tyre dhe hapat e marra për çdo subject në zbatim të ligjit.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar  
Menjëherë dhe në vijimësi***

***(Proces)***

5.1. Sektori i Taksave dhe Tatimeve , të marrë masa për, krijimin e regjistratit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë “familjar” me të gjithë të dhënat e nevojshme , I cili do të shërbeje si bazë për llogaritje të detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Të kërkojmë nga agjenti Shoqëria rajonale UK Gjirokastër xhirimin e vlerës prej 16, 397,158 lekë.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar  
Menjëherë dhe në vijimësi  
(Proces)***

6.1. Sektori i Taksave dhe Tatimeve , Sektori i Bujqësisë, të marrë masa për identifikimin e numrit të familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ata zotërojnë , me qëllim krijimin e regjistratit me të gjithë të dhënat e nevojshme , I cili do të shërbeje si bazë për llogaritje të detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë.



***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar  
Menjëherë dhe në vijimësi  
(Proces )***

7.1. Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të dërgojë periodikisht , informacion në sektorin e Taksave dhe Tatimeve mbi subjektet debitore për “taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa për arkëtimin e saj për 70 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë, si dhe në vijimësi për objektet e tjera që legalizohen , duke bashkëpunuar me ASHK për informacione periodike me legalizime te reja.

***Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit***

***Menjëherë dhe në vijimësi  
(Proces )***

8.1. Sektori i Taksave dhe Tatimeve , Sektori i Bujqësisë, të marrë masa dhe të ndjekë gjithë hapat ligjorë për arkëtim të vlerës prej 3,708,676 lekë, si mospagesë e kontratave të qirasë për 16 subjekte qiramarrës .

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar***

***Menjëherë dhe në vijimësi***

***(Proces )***

9.1. Sektori i Taksave dhe Tatimeve , të marrë masa duke shqyrtuar me dokumentacionin e subjektit “BRAKA”shpk që ky subject të pajiset menjëherë me autorizimin/licensën për ushtrim aktiviteti, duka paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë . Sektori Taksave dhe tatimeve të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura për subjektet : “Braka” shpk; “Olsi” shpk; “Skënderi-G” shpk, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar***

***Menjëherë dhe në vijimësi***

***(Proces )***

10.1 Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar , të vlerësojë gjatë mbajtjes së kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale. Ajo duhet ti evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritje AQT” deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, kontabilizimin në llogatritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitet të kapitalizuar.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar***  
***Menjëherë dhe në vijimë***

**Zbatuar**

11.1 Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar , të vlerësojë veprimet e kryera në librat kontabël të kryera në librat e kontabilitetit, për nxjerrjen e shkakut të deviacionit në vlerën 898,083 lekë të veprimeve ekonomike të ndodhura me debitorët në vite dhe më pas të kryhen sistemit e nevojshme në kontabilitetet në llogaritë e klasës 4, duke i reflektuar përfundimisht në pasqyrat financiare të vitit 2023.

***Drejtoria e Zhvillimit Ek. Menaxhimit Financiar***  
***brenda datës 31.03.2024***

**Zbatuar**

12.1 TË marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, duke mos krijuar kufizime të arkës në pagesën në kohë të faturave, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të palikujduara dhe krijimin e vështirësisë për aftësi paguese.

***Gjithë Drejtoritë***

***Menjëherë në vijimësi***

***Proces***

13.1 Të marren masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik , nëpunësit përgjegjës të Njesisë Prokurimit ; Komisionit të Vlerësimit të Ofertës , kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. Ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK , duka konsideruar faktin se kualifikimi i operatorëve të cilët nuk plotësojnë kriteret , janë risk real për realizimin me sukses të kontratës.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

***Proces***

14.1 Drejtoria e Planifikimit Kontrollit Zhvillimit të Territorit të marrë masa që :

1. Të mos miratohen leje ndërtimi pa miratuar më parë lejen e zhvillimit dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore.
2. Lejet e ndërtimit të miratohen përparë fillimit të punimeve të ndërtimit, të zhvillohet njoftimi i fillimit të punimeve dhe të mbahen akt-kontrollet për fazat e



- ndërtimit që vijojnë pa njoftimit të fillimit të punimeve, duke verifikuar konformitetin e tyre gjatë ndërtimit.
3. Lejet e ndërtimit të mos miratohen pa verifikuar paraprakisht mënyrën e aksesit në objektin që do të zhvillohet, gjurma e objektit të zhvillohet brenda kufirit të pronësisë për të cilën është zhvilluar aplikimi dhe në përputhje me dokumentacionet që vërtetojnë të drejtat pasurore të zhvilluesit.
  4. Lejet e ndërtimit të miratuara, të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara midis ndërtimeve.
